



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA DRENAS



23 03 2016

Nj. Org	Numer	Shtet	Vlera
CA	034-15424		

RAPORTI I PUNËS JANAR-DHJETOR
2015 I KRYETARIT TË KOMUNËS



ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

Zyra e Kryetarit - Në raportin vjetor për vitin 2015 të kryetarit, janë pranuar 1537 kërkesa nga qytetarët të cilave i është përgjigjur, ndërsa zyra e kryetarit ka organizuar edhe dy takime me publikun sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, dhe dy debate me qytetarë për interesat e përgjithshme, njëra për ndërtimin e fabrikës për përpunimin dhe asgjesimin e produkteve shtazore dhe tjetri për Planin Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Drenasit. Po ashtu janë mbajtur degjime buxhetore me qytetarë për të diskutuar planifikimin e buxhetit për vitin 2016, tubimi me banorë dhe biznese të Drenasit për projektin e rriorganizimit të qendrës së qytetit për grumbullimin e mbeturinave dhe tubimi me qytetarë për efikasitet të energjisë elektrike. Gjithashtu janë mbajtur edhe 6 mbledhje me anëtarët e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKS). Nën kryetari i Komunës ka mbajtur takime me përfaqësuesit e fshatrave, ku ka marr nga ta kërkesat të cilat i ka adresuar tek organet përgjegjëse dhe ka diskutuar për çështje të ndryshme. Po ashtu ka pranuar për takim qytetarët e Komunës së Drenasit, ndërsa ka ndihmuar Kryetarin në punët e përditshme.

Zyra për Informim - Zyra e Informimit gjatë periudhës raportuese për vitin 2015 ka përcjellur aktivitetet ditore, javore dhe mujore të Komunës. Përmes linkut zyrtar <http://kk.rks-gov.net/glllogoc/>, web faqës së Komunës ka publikuar të gjitha aktivitetet e mbajtura dhe ka publikuar të gjitha vendimet, rregulloret, raportet, projektet, njoftimet, konkurset, njoftimet e prokurimit (njoftimin për kontratë, njoftimin për dhënie të kontratës dhe njoftimin për anulim të tenderimit) dhe shkresa të tjera në interes të gjithë qytetarëve të Komunës. Ka mbajtur kontakte të rregullta me media, ku i ka përcjellur njoftime e lajme ditore për aktivitetet e zhvilluara në Komunë, ka përcjellë ftesa, reagime etj. Ka përcjellur agjendën e Kryetarit dhe ka caktuar takime në bashkëpunim me Kryetarin me delegacione të ndryshme nga niveli qendror dhe ai lokal si dhe me delegacione të ndryshme ndërkombëtare. Ka pranuar kërkesa të shumta të qytetarëve që i janë adresuar Kryetarit të Komunës dhe në afatin ligjor janë kthyer përgjigjet. Në kuadër të kësaj zyre, zëdhënësi i Komunës, është i ngarkuar me pozitë shtesë për pranimin dhe shqyrtimin e kërkesave fillestare për qasje në dokumente publike dhe në kuadër të saj ka pranuar 44 kërkesa për Qasje në Dokumente Publike dhe në afatin ligjor i janë përgjigjur 41 kërkesave, 1 ka qenë e pjesshme dhe 2 prej tyre i është adresuar Zyrës së Avokatit të Popullit dhe Agjencionit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për shqyrtimin e ligjshmerisë, por nuk ka marrë konfirime se si duhet vepruar me ato dy kërkesa. Ju kemi përgjigjur 9 formularëve të gjuhësisë nëpër Komuna. Zyra e Informimit gjatë vitit raportues ka përgaditur edhe Planin Komunal të Veprimit për Transparencë në Komunën e Drenasit, plan ky i cili është miratuar në mbledhjen e Kuvendit.

Zyra e Auditorit të Brendshëm - Njësia e Auditimit të Brendshëm qysh në Tetor të vitit 2014 ka hartuar Planin strategjik për zhvillimin e aktiviteteve audituese për periudhën tri vjeqare 2015 – 2017, si dhe Planin e punës për vitin 2015. Të dy këto Plane janë të bazuara në rrezik si dhe janë të hartuara pas një vlerësimi të rregullt vjetor të rrezikut. Plani i punës për aktivitetet audituese për vitin 2015 ka paraparë, kryerjen e tetë auditimeve të rregullta gjatë vitit 2015. Deri me 31.12.2015, kjo Njësi ka kryer tetë auditime të rregullta si dhe një auditim plotësues për të vërtetuar shkallën e implementimit të rekomandimeve të dhëna gjatë vitit. Gjatë kësaj periudhe raportuese nuk ka pasur ndonjë auditim të kryer me kërkesë të veçantë, por vetëm ato të parapara me Plan vjetor. Me këtë, Njësia e Auditimit të Brendshëm ka përmbytur në tërësi planin e punës të paraparë për vitin 2015. Fushat e audituara në këtë vit janë: Menaxhimi i pasurive, Të hyrat nga Tatimi në pronë, Qeratë dhe transferi i pronës, Të hyrat nga Taksat për biznese dhe nga Ofiqaria, Të hyrat nga sektori i arsimit dhe shëndetësisë, Auditimi i shpenzimeve/pagesave, Auditimi i avanseve dhe PTC, Auditimi i aktiviteteve të prokurimit, si dhe Auditimi i proqesit të shpërndarjes së subvencioneve. Të gjitha auditimet e kryera janë finalizuar me Raporte dhe janë dërguar në Komitetin për Auditimin e Brendshëm. Komiteti për Auditimin e Brendshëm ka qenë funksional dhe në këtë vit ka mbajtur gjithësej katër takime pune ku ka shqyrtuar dhe aprovuar Raportet finale për auditimet e

kryera nga Njësia e Auditimit të Brendshëm. Në këtë vit, Komuna pret edhe një Raport të Auditimit nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës të vlerësuar me një opinion të pa modifikuar, që paraqet një shkallë të lartë të vlerësimit ku auditori është i knaqr me pasqyrimin dhe pergaditjen e pasqyrave financiare. Njësia e Auditimit të

Brendshëm, ka ndërmarrur një aktivitet për të konstatuar implementimin e rekomandimeve dhe konstatimin se në cilën fazë të implementimit janë rekomandimet e dhëna gjatë kësaj periudhe. Janë bërë përpjekje për të konstatuar në mënyrën më të drejtë shkallën e adresimit të rekomandimeve dhe aktivitetet e ndërmarrura për implementimin e tyre. Gjatë këtij aktiviteti janë zhvilluar intervista me menaxherët dhe janë shqyrtuar mostra për të identifikuar shkallën e implementimit të rekomandimeve dhe aktivitetet që janë ndërmarrur në këtë drejtim. Me rastin e vërtetimit të shkallës së implementimit të rekomandimeve është konstatuar se gjatë vitit 2015, menaxhmenti ka ndërmarrur shumë aktivitete të ndryshme për adresimin dhe jetësimin e rekomandimeve. Njësia e Auditimit të Brendshëm gjatë vitit 2015 ka finalizuar tetë raporte dhe ka dhënë gjithësej 52 rekomandime. Prej tyre, 29 rekomandime janë implementuar në tërësi, 8 janë në proces të implementimit, dhe për 15 rekomandime të dhëna nuk ka një periudhë krahasuese për të vërtetuar shkallën e implementimit të tyre për arsye se kërkojnë një periudhë të gjatë kohore për t'u implementuar.

Zyrës për Integritet Evropiane - Zyra për Integritet Evropiane kemi kryer punët dhe obligimet që parasheh Rregullorja Nr.08/2011 për Organizimin dhe Përgjegjësitë e Zyrave komunale për Integritet Evropiane. Gjatë kësaj periudhe kur po raportojmë punën e kemi mbështetur edhe në Planin e Veprimit për Marrëveshtjen e Stabilizimit Acocimit (PVMSA) 2015 të Miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, që është dokument kryesor afatmesëm planifikues i cili ka për qëllim adresimin e sfidave dhe prioritetëve kyqë afat shkurtë dhe afatmesme ato prioritetë dhe veprime që kanë të bëjnë me Komunën i kemi nda më kohë nëpër drejtorit dhe zyrat. Kemi marr pjesë në Bordin e drejtorëve dhe kemi kontribuar në pikat që kanë të bëjnë me procesin e integritetit evropian. Zyra për Integritet evropianë në vazhdimi kemi punuar në këtë proces kemi patur aktivitete të përditshme me drejtorët e drejtorëve dhe Zyrat tjerë komunal rreth koordinimit, monitorimit, raportimit dhe implementimit të (PVKMSA) dhe lidhur me përmbushjen e tyre i kemi raportuar, Kryetarit dhe Ministrive përkatëse si MAPL-së dhe MI, ku për mesë tyre raportohet në Komisionin Evropian i cili vlerëson punën e të gjitha institucioneve të Republikës së Kosovës. Ndër aktivitetet të rëndësishme të ndërmarr nga Zyra Komunale për Integritet Evropiane në Drenas është edhe shënimi i 9 Maj që është Dita e Evropës në bashkëpunim me Drejtorin Arsimit dhe të Kulturës e Komunës së Drenasit, më dt.07 dhe 08 Maj 2015 kemi njoftuar të dy shkollat e mësimi kemi përgaditur dhe shpërndar broshura informuese për ditën e Evropës, Institutet e BE-së, dhe procesin e Integritetit Evropian. Kurse aktivitetet tjetër të zhvilluar nga Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit në bashkëpunim me (KVLR) të Komunës së Drenasit më datën 08.05.2015 në ora 12.00 në sheshin e qytetit të Drenasit ku të rinjtë u njoftuan për liberalizimin e vizave si dhe kërkuan që edhe rinia jonë të kenë të drejtën për lëvizjen e lire për vendet e BE-së. Kemi mbajtur takime të rregullta të ZKIE në kuader të kolegjiut brenda Asociacionit të Komunave të Kosovës kemi për bërë planin e punës dhe caktimin e prioritetëve për vitin 2015. Kemi marr pjesë në seminarin tri ditorë të organizuar nga Ministria e Integritetit në Kosovë me temën-MSA përvojat e Kroacisë për hyrje në BE-së si dhe trajnimin tjetër katër ditor për kapitujt e Acus të organizuar nga UNDP-ja. Përgaditja e raportit tre mujor, gjashtë dhe vjetor për kryetarin dhe MAPL-në më kohë dhe cilësi të duhur për PVKMSA-në. Raportimi në MAPL, për nivelin e zbatimit të obligimeve ligjore të komunës për Udhërrfyesin për liberalizimin e vizave. Është bërë më rregullë raportimi sipas kërkesës së MAPL-së kryetarit dhe drejtorëve për detyrat që kanë të bëjnë me PVKMSA si dhe sfidat nga Raporti i Progresit që del qdo vit në muajin Tetor. Përmbushja e pyetësorëve në obligimet e komunës në implemtimin e PVNMSA-në qdo tre mujor. Po ashtu kemi patur takime edhe në MAPL, më të cilën kemi koordinuar dhe forcuar bashkëpunimin ndërkomunalë si domos për projektet e komisionit evropian fondin e IPA-së që ka një fond bukur të madh të mjeteve e në këtë drejtim Komuna e Drenasit kemi fituar disa projekte si fusha sportive me vlerën prej 500.000 €, që ka filluar të zbatohet dhe kanë filluar punimet dhe është në përfundim e sipër Projekti për Masat e Energjisë Eficiente në Shkollën e mësimi Gjimnazi "Gjergj Kastrioti Skenderbeu" në Drenas vlera 295.000€ projekt i

cili është kryer në muaj shtator Shkolla fillore "7 Marsi Kisharek vlera e projektit 166.000€ si dhe projekti tjetër i kopshtit të Shkollës fillore "Rasim Kiqina" Drenas që është kryer. Po ashtu për vitin në vijim nga fondet e IPA-së jemi përfitues i ndertimit të objektit të ri të komunës me vlerën prej 980.000 €. i cili objekt është përfunduar dhe që i gjithë stafi i administratës komunale që nga janari 2016 kemi hyrë në të. Marrëveshja e Stabilizim-asocimit (MSA) ndërmjet Republikës së Kosovës dhe bashkimit Evropian në nëntor të vitit kaluar është marrëveshja e parë gjithëpërfshirëse e cila ka vendosur procesin e integritimit Evropian në korniza të obligimeve kontraktuale. Ajo është miratuar nga Qeveria dhe ratifikuar nga Kuvendi në fund të vitit të kaluar dhe do të hyjë në fuqi më 1 prill 2016. MSA kërkon që Kosova të zbaton reforma gjithëpërfshirëse në të gjitha fushat e politikave dhe të përafrojë legjislacionin e saj me acquis-në e BE-në me prioritet në fushat e tregut të brendshëm, tregtisë dhe sundimit të ligjit. Pasi hapi i ardhshëm drejt anëtarimit në BE do të jetë statusi i kandidatit, zbatimi i MSA-së do të kërkojë përkushtimin e të gjitha institucioneve qendrore e lokale dhe palëve tjera të interesuara. Dihet se procesi Integritimit Evropian të Kosovës dhe në veçanti Plani i Veprimit të Qeverisë për Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit ndërmjet bashkimit Evropian dhe Kosovës, e vlerëson si prioritet kryesor rëndësinë e promovimit të sundimit të ligjit dhe luftën kundër korrupsionit në nivel shteti por edhe në atë komunal. Në veçanti Plani i veprimit të Qeverisë parasheh se si: Shërbimet publike dhe funksionimi efektiv i shtetit bazohet në një administratë publike profesionale, efikase dhe transparente. Por procesi Integritimit Evropian është i gjatë dhe i vështirë por me funksionimin efikas të të gjithë mekanizmave mund ti arrijmë dhe zbatojmë detyrat që kemi nga Plani i Veprimit për marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit (PVMSA) si dhe përmbushjen e sfidave që dalin nga raporti i (vendit) progresit për Kosovën i Komisioni Evropian qdo vit.

DREJTORIA E ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME

QShQK /Qendra për Shërbime të Qytetarëve të Komunës:

Raporti sipas departamenteve dhe statusit të zgjidhjes									
Raport i datës 01/01/2015 deri 31/12/2015									
Nr.	Departamenti	Në pritje për pranim	Të pashqyrtuara	Në proces	Miratuar	Refuzuar	Hedhur poshtë	Pezulluar	Totali
1	01-Presidenca	0	247	97	1033	132	4	24	1537
2	02-Drejtorja për Administratë dhe Personel	0	33	9	48443	14	1166	2	49667
3	03-Drejtorja për Ekonomi, Financa dhe Buxhet	0	27	5	7693	2	18	0	7745
4	04-Drejtorja për Bujqësi dhe Zhvillim Rural	0	0	118	830	1	0	0	949
5	06-Drejtorja për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale	0	13	181	1070	2	2	0	1268
6	07-Drejtorja për Gjeodezi, Pronë dhe Kadastër	0	15	3	5874	12	13	0	5917
7	08-Drejtorja për Urbanizëm, Planifikim dhe Zhvillim	0	0	18	705	11	3	3	740
8	09-Drejtorja për Arsime dhe Shkencë	0	3	82	492	561	2	10	1150
9	10-Drejtorja për Kulturë, Rinë dhe Sport	0	13	18	107	13	0	3	154
10	11-Drejtorja për Punë të Inspeksionit	0	16	173	684	6	3	0	882
11	12-Zyra e Kuvendi Komunal	0	75	83	110	1	1	0	270
12	13-Drejtorja për Shërbime Publike dhe Siguri	0	8	65	353	1	2	0	429
13	14-Zyra Komonale për Komunitete e Kithim	0	3	9	6	2	0	0	20
Gjithsej:		0	453	861	67400	758	1214	42	70728

RAPORT VJETOR NGA ZYRA E PROKURIMIT 2015

Zyra e prokurimit gjatë vitit 2015 ka kryer procedurat si në vijim:

1. Janë regjistruar kërkesa fillestare, 3191(Administrata 1318, Arsimi 1691 dhe QKMF-ja 182),
2. Procedurat janë zhvilluar për 183 tenderë për shuma të ndryshme (disa prej tyre të ndara me lot)
3. Nëpërmes e-mailit janë pranuar mbi 2000 kërkesa për dosje, sqarime, shkresa etj dhe po aq janë dërguar duke ju kthyer përgjigje, letra standarde, duke ju dhënë sqarime etj.
4. Janë anuluar 10 tendere (në të cilat janë hartuar njoftimet në të dy gjuhët, dhe letrat standarde për ofertuesit që kanë qenë pjesëmarrës).
5. Janë publikuar njoftimet për kontratë në të dy gjuhët dhe dosjet e tenderëve për procedurat nga 1000 € e më lartë për mbi 151 tenderë (disa prej tyre edhe me 2-3 lote).
6. Janë hartuar dhe nënshkruar mbi 186 kontrata të llojeve të ndryshme dhe të vlerave të ndryshme.
7. Kontrata të nënshkruara për punë, procedura me vlera të mesme 75.
8. Kontrata të nënshkruara për punë, procedura me vlera të vogla (kuotime) 15.
9. Kontrata të nënshkruara për shërbime, procedura me vlera të mesme 7.
10. Kontrata të nënshkruara për shërbime, procedura me vlera të vogla (kuotime) 10.
11. Kontrata të nënshkruara për furnizime, procedura me vlera të mesme 15.
12. Kontrata të nënshkruara për furnizime, procedura me vlera të vogla (kuotime) 22.
13. Kontrata (procedura me vlera minimale) 35.
14. Janë zhvilluar procedurat për tenderë të negociuar (Aneks kontrata) 7 .
15. Janë hartuar dhe dërguar mbi 25 shkresa, sqarime, kërkesa etj.
16. Janë hartuar dhe nënshkruar përtej 190 raporte të vlerësimit, 190 akvendime për komisione të vlerësimit.
17. Janë hartuar procese të hapjes, regjistra të pranimeve, te dorëzimeve dhe akvendime të hapjeve për të marrë pjese në hapje për mbi 180 për secilin tender veç e veç.
18. Gjatë kësaj periudhe në OSHP është ankuar Një OE si i pakënaqur.
19. Janë publikuar mbi 151 dhënie në të dy gjuhët, po aq letra standarde për tenderuesit e pasuksesshëm, po aq për të propozuarin si fitues dhe mesatarisht trefishi i tyre për OE të eliminuar (ku ipen sqarimet për secilin arsyet e eliminimit).
20. Kemi hartuar raporte tre, gjashte dhe nëntë mujore si dhe raportin vjetor për kontratat e nënshkruara të cilin e kemi dërguar në nivelin qendror.
21. Kemi hartuar Planifikim preliminar dhe është dorëzuar në AQP dhe jemi në përfundim të Planifikimit përfundimtar dhe Njoftimit paraprak.

Sektori	Femra	Meshkuj	Nr. i tërësishëm
Administrata	40	97	137
Arsimi	255	709	964
Shëndetësia	97	102	199
Gjithsej	392	908	1300

Dokumentet e lëshuar nga Sistemi i Gjendjes Civile

Komuna: Glogoc
 Prej: 01/01/2015
 Deri: 31/12/2015

Uloji i dokumentit	Totali
Ekstrakti i lindjes	39415
Certifikata e lindjes	5612
Certifikata e martesës	5574
Certifikata e vdekjes	1459
Certifikata e vendbanimit	1000
Certifikata e bashkësisë familjare	3721
Certifikata e gjendjes martesore	1895
Certifikata e shtetësisë	511
Vërtetim nga arkiva	595

59783

Numri i qytetarëve që kanë kaluar regjistrin qendror	12823
--	-------

STATISTIKAT E REGJITRIMIT NË SISTEMIN E GJENDJES CIVILE

KOMUNA: Glogoc
 INSTITUCIONI: Të gjitha
 PREJ: 01/01/2015
 DERI: 31/12/2015

1.E regulltë	134
Brenda vendit	102
Jashta vendit	32
2.Me vonesë	362
Brenda vendit	123
Jashta vendit	239
1.Me numër personal përhapak	9028
2.Me gjenerim të numrit personal	2441
RISHKRIM LINDJE	848
1.Me vendim të komisionit për shtetësi	0
2.Me nenin 28	12
1.E regulltë	613
2.Jashtë vendit	60
1.Brenda vendit	2219
2.Jashtë vendit	35
ANULIM TEKNIK	0
ME ELEMENT TË HUAJ	147
1.Bashkëshorti huaj	15
2.Bashkëshortja e huaj	132
1.E regulltë	87

2.Me vonesë	151
REGJISTRIM I QYTETARIT TË VDEKËR	343

DREJTORATI PËR PLANIFIKIM URBAN DHE MBROJTJE TË MJEDISIT**SEKTORI I PLANIFIKIMIT**

	Nr. i lëndëve
-Numri i kërkesave të pranuara	740 kërkesa
-Leje urbanistike që janë lëshuar gjatë vitit	15
-Leje ndërtimi që janë lëshuar gjatë vitit	26
-Leje rrërimi janë lëshuar ,	2
-Refuzimet për leje ndërtimi ,	5
-Pëlqime për leje të KEDS-it ,	4
-Pëlqime për leje të IPKO,	1
-Pëlqime për leje të shfrytëzimit të terasave ,	16
-Pëlqim për pastrimin e lumit,	1
-Lëshimi i lejes së përkohshme për aktivitete njëditore në sheshin e qytetit	4
- Lëshimi i lejes së përkohshme për lojra dhe Kiosqe në sheshin Fehmi Lladrovci,	6
- Lëshimi i lejeve për reklama	1
- Kërkesa për legalizim të objekteve pa leje	2
- Ndërsa lëndet e tjera kanë të bëjnë me kërkesat dhe nevojat e banorëve për projekte të ndryshme të infrastrukturës	
- Përpunimi i kërkesave për banesa (kontrata të ndryshme, shitblerje etj.)	
-Dorëzimi i tri projekt propozimeve në CDI dhe KUR për ujësjellës, në vendin e quajtur "Pishat e Kamenicës" ,Ujësjellësit në fshatin Baicë, ujësjellësit në fshatin Zabel i Ulët dhe Korroticë e Eperme dhe përfitimi i këtij donacioni.	
-Hartimi i taksës për leje ndërtimi, dhe taksës së densitetit të infrastrukturës,	
-Plotësimi i formularëve për Ministrinë e Financave,	
-Dërgimi i shkresave në Ministrinë e Planifikimit Hapsinor për Planet Urbanistike.	
- Përgaditja e Regjistrat të objekteve të ndërtuara pa leje sipas ortofotove të dhëna nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor, dhe zonave katastrale nga Drejtorati për Gjeodezi Kataster dhe Pronë, të cilat priten të legalizohen gjatë këtij viti në bazë të Ligjit për legalizim dhe udhëzimeve të lëshuara nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor.	

AKTIVITETET

Përgaditja dhe realizimi i projektit për renovimin e SH.M.U "Rasim Kiqina " në Drenas në bashkëpunim me IOM-in,
Përgaditja e projekteve kapitale të komunës për Ministrinë e Infrastrukturës dhe dorëzimi në ministri,
Përgaditja e paramasave dhe parallogarive për projekte kapitale,
Përgaditja e dokumentacionit për tenderim të projekteve, deklarata e nevojave, kërkesave për të gjitha projektet e
Drejtoratit për PUMM,
Përgaditja e kërkesës dhe propozim-vendimit për ndryshimin e disa parametrave në Planin Zhvillimor Urban,dhe
miratimi i tij nga Kuvendi,
Mbikqyrja e punimeve gjatë realizimit të projekteve në teren,
Hapja dhe vlerësimi i tenderëve për projekte kapitale,
Hartimet e raporteve të kërkuara për pagesa nga mbikqyrësit e projekteve kapitale,
Takimi me përfaqësuesit e punëkrësuesit të objektit të administratës Komunale(Komunës) rreth fillimit të ndërtimit.
Takim me përfaqësuesit e REK-ut për caktimin e komisionit për hartimin e projekteve të ndryshme për projekte të
Eficiencës së Energjisë,
Pranimi dhe shqyrtimi i kërkesave të ndryshme gjatë javës,
Puna me palë të ndryshme gjatë javës,
Njoftime të ndryshme për palë rreth kompletimit të lëndëve,

Barazimet financiare rreth faturave me auditorin e brendshëm të Komunës,

Takimi me përfaqësuesen e Bankës Botërore znj. Ganimete Huruglica për mundësinë e përfitimit të donacioneve nga kjo bankë lidhur me ngrohjen qendore të qytetit si dhe takimi në Ministrinë e Zhvillimit ekonomik,

Takimi me përfaqësuesit e punëkryesit të objektit të administratës Komunale(Komunës)

Takime me përfaqësuesit e Komisionit Evropian për Kosovë për Efiqencë të Energjisë,

Takim i Kolegjiumit profesional për Planifikim Hapsinor në kuadër të Asociacionit të Komunave të Kosovës,

Takimet me përfaqësuesit e ujësjellësit dhe KEDS-it dega në Drenas për Objektin e ri të komunës kyqjes në infrastrukturë,dhe realizimi i tyre,

Takimet me përfaqësuesit e Ministrisë së Kulturës,Rinisë dhe Sporteve për stadiumin e qytetit,

Takimi me zyrtarët e Agjencionit Kadastral të Kosovës për emërtimet,shenjëzimet dhe numërtimet e rrugëve lidhur me përfitimin e donacionit,

Njoftimet në kërkesat e qytetarëve për lëndë të ndryshme,

Seminari dy ditor me përfaqësuesit e Komisionit Evropian në Kosovë për Efiqencë të Energjisë,

Takimi me përfaqësuesit e Ujësjellësit Rajonal dhe CDI Zviceriane në Prishtinë dhe caktimi i prioriteteve për projektet e ujësjellësit dhe kanalizimit që duhet të dorëzohen ,

Vizita në objekte sipas kërkesës së Auditorit të brndëshem për verifikim të realizimit të projekteve kapitale.

SEKTORI I PROJEKTEVE

Gjatë realizimit të buxhetit komunal për projektet kapitale që janë paraparë për realizim në vitin 2015 ne si drejtorat jemi angazhuar me tërë stafin që të realizojmë projektet kapitale dhe planin e punës për këtë vit.

Anadaj të gjitha projektet kapitale si:rrugët, trotuaret, ujësjellësi, kanalizimet, ndërtimi i objekteve të reja shkollore, ura, mure mbrojtëse, gropa septike, renovime etj, që janë realizuar gjatë këtij viti, janë kryer sipas kontratave, ndërsa cilësia është në përgjithësi e kënaqshme dhe jemi angazhuar si drejtorat që të kemi një performancë edhe më të mirë brenda mundësive profesionale që i kemi në dispozicion. Po ashtu janë realizuar edhe hartimi i planeve komunale dhe projekteve si:

Hartimi dhe përgaditja e kërkesave fillestare bugetore për projektet kapitale dhe vendosja e tyre në sistemim e PIP-it,

Përgaditja e Raportit vjetor për Sistemin e Menagjimit të Përformancës së Shërbimeve Komunale.

Punimi i projekteve (vizatimeve së bashku me paramasë e parallogari) për shtëpitë skamnore,

Hartimi i aktvendimeve të ndryshme për mbikqyrje dhe pranime teknike të projekteve kapitale

Realizimii projektit për renovimin me masa efieiente për shkollën e mesme të ulët "Rasim Kiqina" në Drenas në bashkëpunim me IOM-in nga programi "Kosova e Bukur" faza e dytë,

Punimi i skicave (projektit ideor) për oborrin në SHML "Gjergj Kastrioti-Skënderbeu" dhe rrethojës në SHMU "Dëshmoret e Qendresës"-Terstenik II,

Dalja në teren për mbikqyrjen dhe pranim teknik të projekteve kapitale,jo veten të drejtoratit të PUMM, por edhe të drejtorateve tjera si (Arsimit, Shërbimeve Publike, Kulturë dhe Drejtorinë e Shëndetësisë)

PROJEKTET KAPITALE QË JANË REALIZUAR GJATË VITIT 2015

Tabela e projekteve të realizuara gjatë vitit 2015

NUMRI I PROJEKTEVE TË REALIZUARA NË INFRASTRUKTURË		
Lloji i projektit	Nr.Projekteve	Gjatësia në m'
RRUGË TË ASFALTUARA	36	21,105
RRUGË ME KUBËZA	9	1,992
TROTUARE	3	2,945
KANALIZIME	21	22,757
NDËRTIMI I URAVE	3	Fshatrat:Dobroshec,Korroticëe e Ult,Gllanasellë
NDËRTIMI I VENDEVE PËR QASJE TË PËRSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR	5	Në pesë shkolla janë realizuar vendet për qasje të PAK

Pra siç po shihet nga tabela për këtë vit janë realizuar 72 projekte kapitale duke përfshirë rregullimin e rrugëve me asfalt dhe kubza, kanalizimeve, trotuareve, urave, mirëmbajtje të një pjese të kanalizimeve, rregullim të rrugëve të rendit të katërt me zhavor etj.

PROJEKTET KAPITALE TË REALIAZUARA NE BASHKËFINANCIM ME KOMUNËN E DRENASIT, MINISTRITË E LINJËS DHE DONATORËT

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor;

-Rregullimi i shtratit të lumit Drenica,	630,000.00 €
- Ndërtimi i rrjetit të Ujësjellësit në Fshatin Arllat	115.000.00€

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal;

-Rregullimi kanalizimit në Poklek të Ri	23,224.50 €
---	-------------

Ministria e Infrastruktues;

-Asfaltimi i rrugës Abri –Terdevc-Gullubovc	866.985.24 €
- Asfaltimi i rrugës në fshatin Kizharekë.....	56,927.50 €

-Renovimi i shkollës "Rasim Kiqina" me IOM-in ,..... 200,000.00 €

-Rregullimi i ndriqimit solar në shesh me UNDP-në,..... 10,000.00 €

-Komisioni Evropian-Ndërtimi i objektit të ri të komunës 1,066,000.00 €

-Projekti për Shtimin e kapaciteteve të ujit për 10 fshatrat e Komunës se Drenasit, ku parashihet që të filloj këtë vit.
703,000.00 €

3,671,137.24€

VËSHTIRËSIT GJATË REALIZIMIT TË PUNËVE

Duhet të theksohet që gjatë realizimit të mbikqyrjeve të projekteve në teren kemi pasur vështërsi, sepse kemi pasur shumë pengesa nga banorët e zonave të ndryshme duke filluar nga uzurpimet e ndryshme të pronave, moslejimi i realizimit të projekteve në pronat private, e deri tek kërcënimet e ndryshme që u janë bërë zyrtarëve të drejtorisë,që në disa raste kanë reflektuar në vonesa të punëve në realizimin e projekteve.

Po ashtu më këtë staf të vogël kemi vështërsi të shumta në realizimin e të gjitha këtyre projekteve kapitale,sepse është dashur që të bëhet,vlerësimi,mbikqyrja dhe pranimi teknikë.

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT

Raporti i punës së Departamentit për Arsim (DKA), përfshinë periudhën prej muajit janar-dhjetor 2015. Të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e këtij Departamenti janë realizuar më përkushtim dhe më përgjegjësi. Me prezantimin e këtij raporti, Kryetari dhe anëtarët e Kuvendit do të jenë më afër njohurive dhe të informuar, sidomos në aspektin zyrtar për punën, organizimin dhe zhvillimin transparent të politikave arsimore në Drenas. Procesi arsimor gjatë kësaj periudhe ka qenë vazhdimisht i përcjellur me kujdes nga Departamenti jonë, ku të gjitha institucionet arsimore janë vizituar disa herë, si nga ana e Drejtorit, ashtu edhe nga zyrtarët e arsimit. Në fund të çdo muaji kemi realizuar mbledhje të rregullta me drejtorë të institucioneve shkollore. Janë mbajtur takime të rregullta edhe më MASHT-in, ku çdo detyrë e dhënë nga ana e tyre është realizuar me sukses nga ana jonë. Ndërsa për Konferencën e

Donatorëve Ndërkombëtarë janë përgatitur projekte ideore në formularët zyrtar të përcjellur me internet nga Qeveria. Për konferencën e donatoreve kemi përgatitur 25 projekte. Drenasi ka një çerdhe, 29 shkolla fillore dhe të mesme të ultë, 5 paralele të ndara, dy shkolla të mesme gjithsejtë 37 institucione shkollore. Ku punojnë gjithsejtë 964 punëtor dhe ndjekin mësimin e rregullt 13849 nxënës. 54 punëtor administrativ, 796 mësimdhënës, 131 punëtor teknik. Çerdhja "Ardhmëria" ka gjithsejtë 136 fëmijë, shkollat fillore të prej (I - IX) ka gjithsejtë 10891 nxënës, Gjimnazi "Gj.K.Skënderbeu" ka gjithsejtë 1489 nxënës, Shkolla e Mesme Teknike ka gjithsejtë 1333 nxënës.

AKTIVITETET DHE DETYRAT E PUNËS -Janë realizuar me sukses mbledhje të rregullta me drejtorë të institucioneve shkollore në Drenas. Në këto takime kemi kërkuar angazhim edhe më të madh të punëtorëve, sidomos në ngritjen e cilësisë në arsim në vitin shkollor 2014-2015,dhe kemi kërkuar respektimin në përpikëri të ligjeve dhe Udhëzimeve të reja Administrative të nxjerrura nga MASHT-i. Kemi realizuar takime me prindër, kemi marruar pjesë në manifestimin në Ditën e shkollës në disa shkolla. Aktivitet që ka përfunduar më sukses është edhe kuizi komunal i organizuar në të gjitha shkollat e nivelit të mesëm të ulet d.m.th (6-9), ku është treguar ky sukses: Në vendin e parë SHFMU "Xhevë Lladrovci" Gllanasellë, në vendin e dytë SHFMU "Bajram Curri" Nekoc dhe në vendin e tretë SHFMU "Naim Frashri" Gllobar. Vizita kemi realizuar edhe në institucionet parashkollore, QEAP "Ardhmëria" në Drenas dhe Bushat. Testi i Arritshmerisë me klasë të nënta është përgatitur më kohë sipas planifikimit të MASHT, në test morën pjesë 1262 nxënës, kaluan testin 65 % e nxënësve. Janë nënshkruar 30 marrëveshje për praktiken profesionale me ndërmarrje të vogla për praktiken profesionale të nxënësve, me Ndërmarrja NeëCo "Feronikeli" kemi nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi për të kryer praktiken profesionale nxënësit e SHMP "FEHMI LLADROFCI". Matura rezultatet; Gjimnazi "Gjergj Kastrioti-Skënderbeu" 85 % kalueshmëria, SHMP "Fehmi Lladrofc" rezultati i maturës 46 % kalueshmëria.

DONACIONET - Ka përfunduar renovimi i SHFMU "RASIM KIÇINA" Drenas, investim i IOM, donacion. Projekti "Teknologji e Informacionit dhe Komunikimit dhe mësimi elektronik në Arsim", për Gjimnazin "Gj.K. Skenderbeu", investim i BE. Në SHFMU "Shotë Galica" në Tërdec OJQ më seli në Shkup i ka dhuruar shkollës inventar, lekturë shkollore, kompjuter në vlerë 4000 mijë euro. Në SHFMU "Rilindja" ne Dritan, disa bashkëfshatar ja kanë dhuruar shkollës dhjetë kompjuter të ri. Në SHFMU "Xhevë Lladrovci", donacion nga NeëCo Feronikeli, për kabinetin e lëndës së kimisë, dhe çanta për 40 nxënës të kësaj shkolle. Donacioni në SHFMU "Mehmet Gradica" në Gradicë, nga bashkëfshataret për sigurimin e ujit të pijes dhe rregullimi i fasadës së jashtme të shkollës dhe rregullimin e një qeshme në oborrin e shkollës .

INVESTIMET KAPITALE - Ka përfunduar renovimi i SHFMU "Xheladin Gashi- Plaku",Komoran, investim i MASHT-it. Ka filluar ndërtimi i aneksit të shkollës "7 MARS", Kizhnarek, investim i MASHT-it, ka përfunduar renovimi i SHFMU "Shaban Polluzha", Korroticë e Epërme investim i MASHT-it, dhe i infrastrukturës së oborrit të shkollës dhe terrenet e sportit, ka përfunduar rregullimi infrastrukturës së oborrit të shkollës dhe terrenet e sportit në SHFMU, "Naim Frashri" Gllobar, investim i MASHT-it. Ka përfunduar ndërtimi i fushave të sportit në këto shkolla, "Migjeni" Baicë, "Shotë Galica" Grykas, "Xhevë Lladrovci", Gllanasellë, "Zenel Hajdini" Terstenik, "Bajram Curri" Nekoc dhe "Fazli Greiqevci", Vasilevë, investime të Komunës. Ka përfunduar ndërtimi i rrethojës së shkollës "Dëshmoret e Qëndresë" Terstenik II, është rregulluar një pjesë e hyrjes të oborrit të Gjimnazit, është përfunduar rregullimi i dyshemesë së klasave dhe të bodrumit në shkollën "Mehmet Gradica" Gradicë. Ka përfunduar rregullimi i nxehjes qendrore në SHFMU "Rasim Kiçina" në Drenas investim i Komunës. Ka filluar ndërtimi i SHFMU "Hasan Prishtina" investim i MASHT-it.

KOMUNIKIMI ME MASHT-in - Gjatë kësaj periudhe kemi realizuar takime të rregullta me MASHT-in. Ndërsa në kërkesat tona për investime kapitale janë realizuar pesë prej tyre, investimet e MASHT-it, vazhdojnë edhe në

ketë vit. Në çdo mbledhje me drejtorë të departamenteve për Arsim janë paraqitur kërkesat tona dhe gjithashtu janë marruar detyra nga MASHT-i, janë paraqit edhe vështirësitë që i ka DKA-në, Drenas për pagesat e pushimeve të lehonave dhe tri pagat jubilarë.

BASHKËPUNIMI ME BE-në - Edhe në këtë vit kemi pasur bashkëpunim të shkëlqyeshëm me BE-në për interesin e përgjithshëm të arsimit në Drenas, (BEP,GIZ-in) USAID, etj. Po vazhdon certifikimi edhe i kandidatëve të tjerë për drejtor të institucioneve arsimore në Programin për Udhëheqje dhe Menaxhim të Shkollës. Janë certifikuar 90% e mësimitdhënëseve nga projekti i BE-së i implementuar nga GIZ-i në bashkëpunim me Fakultetin e Edukimit, trajnimet e mësimitdhënëseve po vazhdojnë edhe gjatë këtij viti shkollor. Po vazhdojnë trajnimet mësimitdhënëseve për kurrikulën e re.

VËSHTIRËSITË - Vështirësitë janë edhe obligimet financiare të mësimitdhënëseve të pa pagurë gjatë zëvendësimeve të pushimeve mjekësore, (pushimet e lehonave), tri pagat jubilarë të mësimitdhënëseve. Kemi pasur vonesa në fillimin e vitit shkollor për shkake të renovimit të shkollave, (për të cilat ka filluar orari i zëvendësimit të orëve). Stafi profesional na mungon në shumicën e shkollave (sekretar, pedagog, psikolog). Në shumicën e shkollave punët administrative, pedagogjike etj, i kryen drejtori i shkollës.

DREJTORIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK

Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Ekonomik, gjatë këtij viti, ka kryer punët dhe detyrat në të gjitha lëmit përkatëse që janë në kompetencë të këtij drejtorati, në bazë të Statutit të Komunës. Në komunën e Drenasit bujqësia po shëndërrohet në një sektor të rëndësishëm të zhvillimit ekonomik duke patur parasysh kushtet e volitshme si nga aspekti pedologjik po ashtu edhe në ai klimatik. Komuna e Drenasit ka për qëllim që të zgjerojë kapacitetin e zhvillimeve bujqësor, ku për mes saj do të hapen vende të reja të punës, e po ashtu si qëllim kryesor do të jetë rritja e prodhimeve vëndore dhe ulja e importit. Gjithashtu janë bërë reforma të volitshme në politikat administrative dhe fiskale për të gjitha bizneset që operojnë në Komunën e Drenasit duke krijuar një ambient të volitshëm për investitor të ndryshëm.

SEKTOR I BUJQËSISË

Këshillime fermerëve për të gjitha sektorët e ndryshme të bujqësisë.

Këshillime dhe udhëzime fermërve rreth aplikimit për Grande në MBPZHR, në sektorët e ndryshëm.

Këshillime fermërve rreth aplikimit për subvencione në pagesa direkte në sektorët e ndryshëm të bujqësisë.

Regjistrimi i fermerëve të rinj në regjistrin e fermës (NIF).

Është bërë planifikimi dhe realizimi i të mbjellurave vjeshtore 2015-2016 (të planifikuara për kulturat e ndryshme, 4310 ha prej tyre janë realizuar 4117 ha).

Është bërë planifikimi dhe realizimi i kulturave të ndryshme pranverore (të planifikuara 2829 ha prej tyre të realizuara 2478 ha).

Përgaditja rreth Korrje-Shirjëve, bashkëpunim me MBPZHR, auto kombanjerët, fermerët dhe pika grumbulluese të drithërave në teritorin e Komunës së Drenasit.

Çmimi i korrje -shirjeve ka qenë 100€ për ha.

Kompania-Ndërrmarrja e "IBËR LEPENCË", Njësia e Punës në Komoran, gjatë këtij viti ka punuar në rregullimin e rrjetit të ujitjes, dhe ndërrimin e pjesëve të dëmtuar në rrjet, në mënyrë që të zgjerohën sipërfaqët e ujitura, tani rrjeti i ujitjes është i aftësuar me 2950 ha, ndërsa të ujitura janë mbi 351 ha.

Ka filluar projekti "Zhvillimi i Zonave Rulale" përmes avancimit të Sherbimëve Këshillimorë, ku janë duke u indentifikuar temat më të rëndësishme, si problemet ashtu dhe njoftimet të cilat do të jenë të rëndësishme për fermerët. Kjo do të ju ndihmojë që fermerët të jenë të informuar për problemet të ndryshme, afatët e kultivimit si dhe mundësit të ndryshme në shërbime bujqësore. Është bërë vlerësimi dhe ekspertizat e dëmeve në kulturat e

ndryeshme bujqësore-lavertare të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore, janë dorëzuar në MBPZHR për kompensim e dëmeve të 40 fermerëve. Është bërë vlerësimi dhe ekspertizat e dëmeve në kulturat bujqësore perimkultur-Serra të shkaktuara nga erërat e forta, janë dorëzuar në MBPZHRE për kompensim e dëmeve të 45 fermerëve.

Projektet nga Komuna

Perimkulturë –Serra

Furnizimi i 17 fermerëve me serra prej 2.40 ari (240 m²) me bashkë-financim, Komunë dhe fermër (1739.5€, 70 % ,dhe 745.5€, 30 % / serre). Vlera e këtij projekti ka qenë **42,245.00 €**. (një serre ka kushtuar **2,485.00 € x 17 copë = 42,245.00 €**).

Bletari - me shoqëri te bletëve, 60 fermër me nga 2 bletë gjithsejtë 120 shoqëri të bletëve. Furnizimi i fermerëve ka qenë projekt me bashkë-financim Komuna dhe Ri-invest (3,000.00 € ,25% dhe 9,200.00 €,75%),vlera e këtij projekti ka qenë 12,200.00€ .

Furnizimi i 113 bletarëve me ushqim për bletë (Pogaçe), për 3540 koshere bletësh janë dhënë 4800 Pogaçe-ushqime për bletë në vlerë prej 6.960.00 €.

Blegtari- mekanizim blegtoral

Furnizim i fermerëve me mekanizim për ngarkues të plehut organik.Përfitues kanë qenë 12 fermër që kanë poseduar mbi 15 lopë qumështore. Ky projekt është realizuar me bashkë-financim Komunë dhe fermër (1592€,80% dhe 398€,20%/ mekanizim). Vlera e këtij projekti ka qenë 23,880.00 €, (nje mekanizimi-luga ngarkuese për pleh organik ka kushtuar (1990.00€ x12copë=23,880.00 €).

Pemtari-fidane të mollës

Furnizimi i fermerëve me fidanë(mollë) të pemëve organik, përfitues të këtij projekti janë 52 fermër me nga 10 ari pemishte.

Ky projekt është realizuar nga DBZHE , vlera e këtij projekti ka qenë 3,480.00 €(1 fidanë ka qenë 0.58 € ,6000 fidane x 0.58€= 3,480.00).

Projektet nga MBPZHR

Është bërë informimi i fermerëve për aplikimi rreth graneve, subvencionimeve për pagesa direkte: grur, misër, luledielli,farë gruri, pemë, perime ,blegtori dhe bletari. Pran DBZHE është bërë DIGJITALIZIMI i parcelave të mbjellura , janë bërë te gjitha pranimet e aplikacioneve të fermerëve që kanë aplikuar në programet e ndryshme për subvencionime nga MBPZHR , janë kompletuar dukumentacionet dhe janë dërguar në Ministrin e Bujqësisë gjegjësisht në Agjencionin e pagesave. Grandet - kanë përfituar 11 fermër, në projekte e ndryshme të bujqësisë me vlerë prej: 611.270.70 € .

Subvencionet:lavërtari, pentari perimkultur

Subvencionimi i të mbjellurave me grurë, kanë aplikuar 520 fermër, me sipërfaqe prej 2137.16 ha,kanë përfituar 429 fermër,me sipërfaqe prej 1600.05 ha, vlera e përgjithshme e subvencionimeve që kanë përfituar fermerët nga MBPZHR është 240,007.50 €.

Subvencionimi i të mbjellurave me misër, kanë aplikuar 296 fermër, me sipërfaqe prej 690.86 ha, kanë përfituar 259 fermër me sipërfaqe 616.02 ha vlera e përgjithshme e subvencionimeve nga MBPZHR që kanë përfituar fermerët është 92,403.00 €.

Subvencionimi i te mbjellurave me lule dielli, ka aplikuar 1 fermër, me sipërfaqe prej 54.96 ha, ka fituar 7,447.00€ me sip 49.64

Subvencionimi i Plantacioneve me pemë, kanë aplikuar 65 fermër, me sipërfaqe prej 73.47 ha, kanë përfituar 60 fermër me sipërfaqe 69.61.00 ha .Vlera e përgjithshme e subvencionimeve nga MBPZHR është 27,844.00 €.

Subvencionimi i Perimkulturës –(në fushë të hapur), kanë aplikuar 21 fermër, me një sipërfaqe prej 44.06 ha, kanë përfituar 15 fermër me sipërfaqe 17.02 ha.Vlera e përgjithshme e subvencionimeve nga MBPZHR është 5,106.00 €

Subvencionet: Blegtori, bletari

Subvencionimi i lopëve qumështore –përfitues kanë qenë 162 fermër me gjithsej 1145 krerë lopë qumështore, subvencionimi për një lopë qumështore ka qenë 70 €.Vlera totale e fituar e fermerëve nga MBPZHR është :

$(1145 \text{ krere} \times 70 \text{ €} = 80,150.00\text{€})$

Subvencionimi i deleve, dhive - përfitues kanë qenë 36 fermër me gjithsej 3419 krerë dele,dhi, subvencionimi për një dele,dhi ka qenë 15 €.Vlera totale e fituar e fermerëve nga MBPZHR është:

$(3419 \text{ krere} \times 15\text{€} = 51,285.00\text{€})$

Subvencionimi i shoqërive me bletë- përfitues kanë qenë 46 fermër me 2748 koshere bletë, subvencionimi për një koshere ka qenë 10 €.Vlera totale e fituar e fermerëve nga MBPZHR është :

$2748 \text{ koshere} \times 10 \text{ €} = 27,480\text{€}$

Subvencionimi për qumësht/litër sipas kategorive të cilësisë

Kanë aplikuar 7 fermër për subvencionime të qumështit sipas kategorive:ekstra klasë 0.06€ ,Klasa e parë 0.04€ ,klasa e dytë 0.02€ për tremujorët e parë ,dytë ,tretë dhe të katërt . Vlera totale e fituar e fermerëve nga MBPZHR për tre mujorin e parë dhe të dytë është: 2,407.60€(për tre mujorin e tretë dhe katërt ende nuk janë subvencionuar).

Projektet e realizuara në bashpunim me IADK, dhe shoqata tjera implementuese të projekteve të Fin.nga KE.

Është bërë marrëveshje bashkëpunimi-Memorandum në mes të KOMUNËS - DBZHE dhe IADK-së për mbajtje të trajnimeve, për ngritjen e kapacitetëve të fermerëve në sektore të ndryshme të bujqësisë si në pemtari,perimtari,blegtori, përpunim i teknologjisë ushqimore,konzervim e tj. Janë ngritur 10 plantacione me nga 10 ari mjedër dhe 3 plantacione me Rigon të bardhë përfitues fermerët e Komunës sonë projekte të financuara nga IADK-ja me bashkfinancim nga Komuna e Drenasit. Komuna ka përfituar grantt nga KE me shoqëri te bletëve , 60 fermër me nga 2 bletë gjithsejtë 120 shoqëri të bletëve . Ky projekt ka Furnizimi i fermerëve qenë projekt me bashkë-financim Komuna dhe Ri-invest-KE (3,000.00 € (Komuna,25%) dhe 9,200.00 €,75% nga KE-Riinvest), vlera e këtij projekti të realizuar ka qenë 12,200.00€. Janë organizuar trajnime dhe këshillime me fermër për sektore të bujqësisë nga IADK-ja, KDC-ja, Shoqatat Gratë në Biznes, USAID-i, COSULT INGENEERING,ESG, Etj.

SEKTORI I EKONOMISË

RAPORTI VJETOR 01.01.2015 – 31.12.2015

Sipas Qendrës Komunale **ONE STOP SHOP** për Biznese, numri i bizneseve të regjistruara nga data 01.01.2015 deri me datën 31.12.2015 janë të regjistrua 263biznese të reja , krahasuar me periudhëparaprake që ishin regjistruar272bizneseose shprehur në përqindje 4.2% më pak se në vitin e kaluar, të cilat biznese në bazë të deklarimeve të tyre punësojnë 395 punëtorë. Bizneset fillestare brënda ditës paisën me çertifikatën e biznesit, numërin fiskal me deklarim vullnetar paisën edhe me çertifikatën e TVSH dhe çertifikatën doganore, pranë kësaj

Qendre ipën të gjitha konsulencat e nëvojshme të kësaj natyre për ta krijuar një ambient sa ma të volitshëm për regjistrimin dhe të gjitha ndryshimet e nëvojshme në biznes. Shikuar në bazë të kësaj periudhe ky numër i bizneseve të regjistruara duket si vijon :

Tabela e klasifikimit të bizneseve sipas numrit të punë

Klasifikimi sipas madhësisë	Numri i punëtorëve	Numri i bizneseve	Përqindja në total
Të vogla	1-5	263	100.00%
Të mesme	5 - 60	-	-
Të mëdha	60- e më tepër	-	-
Gjithsejt:		263	100.00%

Nga tabela e paraqitur më lartë vërehet se të gjitha bizneset e regjistruara në periudhën 01.01.2015 – 31.12.2015 i takojnë ekskluzivisht kategorisë së bizneseve të vogla (100.00%)

Nr.	Bizneset kryesisht janë të përqendruara në këto veprimtari:	Shpërndarja e bizn. Sipas veprimtarive	Përqindja
1.	Tregti	147	56.00%
2.	Transporti	13	5.00 %
3.	Ndërtimtari	35	13.00 %
4.	Hoteleri	10	4.00 %
5.	Bujqësia	27	10.00 %
6.	Shëndetësi	6	2.00 %
7.	Industri- zëjtari prodhuese	12	5.00 %
8.	Arsim	14	5.00 %
	Gjithësejtë.....	263	100.00 %

Bizneset e regjistruara në Komunën e Drenasit sipas llojit të pronësisë në periudhën

Nr.	Lloji i pronësisë	Numri i bizneseve	Përqindja
1	Biznes individual	241	92.00%
2	Ortakëri e përgjithshme		
3	Ortakëri e kufizuar		
4	Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar	22	8.00%
5	Shoqëri Aksionare		
6	Ndërmarrje në pronësi të huaj		
7	Ndërmarrje publike		
8	Kooperativë bujqësore		
	TOTALI	263	100.00%

Të dhënat e QKB të paraqitura në tabelën e mësipërme ofrojnë informata në lidhje me strukturën pronësore të bizneseve të regjistruara me 01.01.2015 – 31.12.2015 në Komunën e Drenasit. Bizneset individuale gjatë kësaj periudhe ekskluzivisht dominojnë strukturën pronësore bizneset individuale me 92.00%. Gjatë periodës 01.01.2015 – 31.12.2015, në vijim me kërkesën e pronarëve të bizneseve janë regjistruar gjithsejtë: 165 ndryshime të bizneseve ekzistuese ,në periudhën e vitit paraprak bizneset që patën ndryshime ishte 122 biznese, ose 44.00% ma shumë se viti paraprak dhe sipas muajve dukën kështu:

Nr.		I	II	III	IV	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	TOT.
1.	Ndryshi met në biznese	12	18	13	15	16	17	16	11	14	16	17	165

Janë regjistruar 95shuarje dhe janë ndërruar 37 certifikata me logo të UNMIK-ut si dhe janë zëvendësuar me certifikata me logo të Republikës së Kosovës . Në periudhën 01.01.2015 - 31.12.2015 janë Arkivu 1060landë, janë faturu dhe paisë me vërtetima 121 biznese në vlerë 99,750.00euro,vertetima qe nuk ka biznes të regjistruar 25 janë dorzu raporte për biznese në MTI,konsulenca rreth bizneseve,sistemimi dhe azhurimi i lëndve në foldera dhe programe të caktuara në QKB si dhe për inkasim të taksës Komunale sidhe punë të tjera sipas nëvojës së DBZHE .

Aktivitetet tjera trajnuese dhe konsulenca në Qendrën ONE STOP SHOP pranë DBZHE ishte122biznese, ose 44.00% ma shumë se viti paraprakdhe sipas muajve dukën kështu:

Nr.		I	II	III	IV	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	TOT.
1.	Ndryshi met në biznese	12	18	13	15	16	17	16	11	14	16	17	165

Janë regjistruar 95 shuarje dhe janë ndërruar 37 certifikata me logo të UNMIK-ut si dhe janë zëvendësuar me certifikata me logo të Republikës së Kosovës . Në periudhën 01.01.2015 - 31.12.2015 janë Arkivu 1060 landë, janë faturu dhe paisë me vërtetima 121 biznese në vlerë 99,750.00euro,vertetima qe nuk ka biznes të regjistruar 25 janë dorzu raporte për biznese në MTI,konsulenca rreth bizneseve,sistemimi dhe azhurimi i lëndve në foldera dhe programe të caktuara në QKB si dhe për inkasim të taksës Komunale sidhe punë të tjera sipas nëvojës së DBZHE .

SEKTORI I PYLLTARISË

Gjatë kësaj periudhe raportuese Autoriteti Pyjorë Komunal në Drenas ka patur një angazhim pëmanent në mbrojtjen e pyjeve shtetërore dhe private.Ky Autoritet ka koordinuar aktivitetet në një bashkëpunim të ngushtë me Policinë, Gjykatën, Njësinë e zjarrfikësve dhe me Drejtorinë Koordinuese pranë APK në Prishtinë.Mbrojtja e pyjeve në komunën e Drenasit është e kënaqshme dhe mund të themi se është në nivel të lartë të regjionit. Pylltarët së bashku me zyrtarët e këtij Sektori kanë pasur një angazhim të lartë në mbrojtjen dhe menagjimin e pyjeve të Sektorit privat dhe ati Shtetërorë.

Aktivitetet në Vitin 2015:

-Mbrojtja dhe ruajtja permanente e pyjeve nga prerjet ilegale, -Monitorim i përhershëm.

-Kontrolla pyjore në në rajonin e Qyqavicës,Kosmaqit dhe Pallanikut

Si dhe inspektime në tregjet e Drenasit dhe Komoranit.....50 kontrolla.

-Veprimet (rrallimet)Silvikulturore janë kryer në sipërfaqe prej25.30 ha.në objektin pyjorë të Pallanikut dhe Qyqavicës ku për kryerjen e këti aktiviteti janë angazhuar 20 punëtorë sezonal.

-Regjistrimi i dëmeve të pyjeve është kryer në bashkpunim me APK në 2(dy) objektet pyjore në at të Qyqavicës dhe të Kosmaqit ku kemi patur dëme më të theksuara duke patur parasyshë mungesën e Rojës së pyllit për të keqsimin të gjendjes shëndetsore të tijë i cili ka këkuar të nderpres mardhenjen e punes dhe të realizoj pensionin e Veteranit të Luftës së Uçk-së..

-Pjesmarrja e zurtarve në 15 Seanca në gjykatën Komunale në Drenas dhe at të Apelit në Prishtinë

- Gjithësejtë fletëparaqitje të ngritura61

-Kundervajtëse12

-Penale49

-Gjithësejtë Seanca Gjygesore20

-Penale..... 8

-Kundërvajtëse12

DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE DHE EMËRGJENCË

Aktivitetet Kryesore në periudhën Janar-Dhjetor 2015 për realizimin e prioritetëve

Në pajtim me nenin 17 pika f ,e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenit 82 të Statutit të Komunës së Drenasit, Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë, gjatë vitit 2015 është angazhuar që të realizojë punët dhe detyrat që kanë qenë të parapara me programin e punës. Gjatë periudhës Janar-Dhjetor të vitit 2015 janë pranuar gjithësej 427 kërkesa të ndryshme, ku prej tyre të miratuara janë gjithësej 373, në proces gjithësej 53 dhe të refuzuara 1. Kërkesat kanë të bëjnë me transportin rrugorë, vërshime, zhavorr, pastrim kanalizimi , pastrim të deponive , ndihma emergjente etj. Qellimi ynë ka qenë dhe është zgjidhja e kërkesave në shërbim të qytetarve, ne menyrë sa më efikase dhe sa më të shpejtë. Lidhja me kohë e kontratave për projekte kapitale ka mundësuar shërbim sa më të shpejtë dhe më cilësor.

Spektori i shërbimneve Publike -Paisja e Operatorve Ekonomik me leje operimi AUTOTAX-i. Zgjerimi i shërbimit për menaxhimin e mbeturinave (në fshatrat Nekoc, Çikatovë. Llapushnik, Krajkovë) ku deri tani mbulueshmëria me kryerjen e shërbimit për menaxhimin e mbeturinave në territorin e komunës sonë është mbi 65%. Takime të vazhdueshme me Grupin Punues për hartimin e Planit komunal për menaxhimin e mbeturinave. Marrja e aksioneve për pastrimin e qytetit nga mbeturinat në bashkëpunim me të gjitha instiucionet dhe OJQ-të me qëllim të ruajtjes së ambientit. Largimi i Deponive ilegale në territorin e komunës së Drenasit. Vendorsja e tabelave lajmëruese për mos-hedhjen e mbeturinave në deponitë ilegale. Mirëmbajtja e Kanalizimit dhe gropave Septike të ujërave të zeza si dhe kanalizimit të të reshurave atmosferike nëpër rrugët e qytetit dhe fshatrave në komunën e Drenasit.

Spektori i mbrojtjes dhe shpëtimit - Përpilimi i informatave periodike dhe raporte mujore të punës për Departamentin e Menaxhimit të Emergjencave të Kosovës lidhur me numrin e intervenimeve , me ecurinë dhe problematikën e punës profesionale, konsulta në nivel të ekspertëve në kuadër të Drejtorisë dhe të Departamentit të menaxhimit të emërgjencave në nivel qendror. Vlerësimi i dëmëve në territorin e komunës nga fatkeqësit elementare dhe natyrore si zjarre, vërshime, erëra etj) 68 raporte të hartuara. Gjithësej vlera totale e dëmëve gjatë vitit 2015 është 379,326,00 €.

Shërbimi i Zjarrfikësve - Numri i përgjithshëm i daljeve në teren ka qenë 267 (dyqind e gjashtëdhjetë e shtatë) raste. Numri i intervenimeve nga zjarret 193 (njëqind e nëntëdhjetë e tre) raste. Intervenimet teknike-akusidente 19 (nëntëmbëdhjetë). Intervenime të rrejshme 7 (shtatë). Të vdekur 1 (një) person.

Projektet kapitale të reaalizuara gjatë periudhës janar-dhjetor 2015- Mirëmbajtja e parqeve dhe gjelbërimi i qytetit. Renovimi i rrugëve të asfaltuara. Mirëmbajtja e rrugëve gjatë Verës. Mirëmbajtja e rrugëve gjatë Dimrit. Pastrimi i deponive të egra. Shenjzimi Vertikal dhe Horizontal. Blerja e kontejnerëve për mbeturina. Rregullimi i varrezave në komunën e Drenasit. Mirëmbajtja e kanalizimeve fekal, atmosferik dhe gropa septike. Mirëmbajtja e rrugëve të rendit të katërt me zhavor. Trajtimi i qenëve endacak. Blerja e një automjeti për SHZSH. Mirëmbajtja e rrugëve të rendit të -IV- me zhavor.

DREJTORIA PËR BUXHET E FINANCA

Drejtoria për Buxhet dhe Financa gjatë vitit 2015, punët dhe detyrat e punës i ka kryer duke u bazuar në Plan-programin e punës, të mbështetur në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë nr.03/L-048, Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal nr. 03 / L-049, Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03 / L-040, rregulloret, vendimet, udhëzimet e Ministris së Financave dhe Kuvendit të Komunës, si dhe në bazë të detyrave dhe obligimeve të përcaktuara me Statutin e Komunës së Drenasit.

Ky Drejtorat, punën e vetë kryesisht e ka orjentuar në këto lëmi:

- plani i punës për vitin 2015,
- raporti i punës dhe financiar për vitin 2014,
- pasqyrat financiare 2014,
- procesi buxhetor-Strategjia Fiskale 2016-2018, sipas kërkesave të programeve,
- raportet financiare sipas muajve dhe periudave të vitit /015,
- aprovimi i shpenzimeve dhe certifikimi për buxhetin komunal sipas programeve ,
- kryerja e pagesave lidhur me shpenzimet operative dhe kapitale, si dhe barazimi me raportet e Sistemit Informativ të Menaxhimit Financiar të Kosovës (SIMFK) ,
- punët lidhur me arkën e parave të gatëshme (arkëtimi dhe pagesat),
- regjistrimi në sistemin kompjuterik i të gjitha të hyrave të arkëtuara nga burimet vetanake dhe barazimi ditor, javor, mujor dhe periodik me SIMFK,
- autorizimi i shpenzimeve për Drejtoratin për Buxhet dhe Financa,
- përcjellja e të hyrave publike të akorduara nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës,
- përgatitja e transfereve të parave të depozituara në llogaritë e thesarit të M.F-it,
- caktimi i tatimit në pronë- shpërndarja e faturave për vitin 2015,
- caktimi i taksave dhe ngarkesave tjera,
- evidentimi i objekteve të reja si pasuri e palujtëshme dhe rimatja e objekteve ,
- përgatitja e analizave mujore lidhur me zhvillimin e buxhetit komunal,
- punët lidhur me zbatimin U.A nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Komunale
- punët lidhur me përgatitjen e propozim vendimeve dhe vendimeve për buxhetin,
- përgatitja e Kornizës Afatmesme Buxhetore 2016-2018 dhe buxheti 2016-2018,
- përgatitja e rishikimit të buxhetit komunal/015,
- shlyrja e pagesave për tatimin në pronë,
- plotësimi i formularëve për buxhetin 2016-2018, sipas programeve,
- punët lidhur me ridestinimin-transferin e mjeteve buxhetore të vitit 2015,
- në trajnimin e puntorëve të Drejtoratit për Buxhet dhe Financ,

- punë dhe detyra tjera të punës për pushtetin lokal dhe qendror,
- aktivitetet lidhur me zbatimin e Ligjit Nr.05/L-043 për faljen e borxheve publike,
- punët me palë në lëmin e buxhetit dhe financave.

Struktura e përgjithshme organizative për funksionet e Drejtoratit për Buxhet dhe Financa, tani më është e bazuar në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Ligjin për Vetëqeverisjen lokale, Statutin e Komunës, sipas Sektorit të Buxhetit-Zyra e Tatimit në Pronë, Thesarit dhe Financave.

Spektori i Buxhetit- Për vitin raportues/015, ka kryer këto punë dhe detyra pune:

- zhvillimi i aktivitetit lidhur me planifikimin e buxhetit komunal 2016-2018, sipas kërkesave të programeve dhe kategorive kryesore ekonomike të shpenzimeve,
 - përgatitja e Qarkoreve 01/015, 02/015 dhe 03/015 Interne buxhetore,
 - përgatitja e Kornizës Afatmesme Buxhetore të shpenzimeve 2016-2018,
 - vërtetimi i deklaratave të nevojës për sigurimin e parasë publike lidhur me projektet kapitale dhe projektet tjera, para shpalljes së tenderve,
 - përgatitja e formularve PIP-1, të projekteve kapitale,
 - përgatitja e formularve për të gjitha kategoritë ekonomike të shpenzimeve lidhur me buxhetin komunal 2016-2018, sipas programeve,
 - punët lidhur me ridestinimet-transferet e mjeteve sipas nevojës ,
 - përgatitja e planit të zotimit dhe shpenzimit të parasë publike sipas programeve dhe kategorive kryesore ekonomike të shpenzimeve për vitin fiskal 2015,
 - aktivitetet e zhvilluara për organizimin e dëgjimeve buxhetor me qytetarët e Komunës së Drenasit ,
 - përgatitja dhe dërgimi i raporteve në Ministrinë e Financave-Departamentin e Thesarit lidhur me faturat e pa paguara sipas muajve,
 - caktimi i taksës për personat që kanë pasuri të luajtshme, në numër prej 7730,
 - numëri i kontratave për transferin e pronës të vertetuara 143 ,
 - për personat që janë pronar- shfrytëzues të pasurisë së palujtëshme (objekte), janë lëshuar 10908 vërtetime,
 - për personat që janë pronar të pasurisë së luajtshme janë lëshuar 7730 vërtetime,
 - numëri i vërtetimeve tjerë për qytetarët lidhur me rregullimin e dokumentacionit gjithësejt janë lëshuar 1985 vërtetime,
 - numëri i kërkesave të regjistruara dhe koduara për shpenzime nga shfrytëzuesit e buxhetit komunal 3253,
 - regjistrimi i pagesave të tatimpaguesve përmes arkës422,
 - lëshuarja e faturave sipas kërkesës së palëve 438,
 - ruajtja e databases për të dhënat e regjistruara,
 - objektet e reja të matura – rimatura 426,
 - fatura të shpërndara përmes poste 1073,
 - numëri i ankesave të pranuar 54 ,
 - pranimi i kërkesave për verifikimin e objekteve të pa luajtshme 182,
 - regjistrimi i kontratave të shitblerjeve 18,
 - korigjimi manual i pagesave 118,
 - riprogramimi i marveshjeve për pagesë në sistem 143,
 - korigjimi manual i faturave të përlllogaritura gabim 636,
 - përgatitja e lëndëve nga NSH për AKP-në për pagesën e TPR-së 37,
- Angazhimet e bëra nga Zyra e Tatimit në Pronë-DBF, lidhur me arritjen e një performance të ngritur për arkëtimin e tatimit në pronë, pasqyrohet nëse bëjmi krahasimin e planifikimit (290.000,00€) si të hyra vetanake me arkëtimin (327.455,01€) i cili paraqet tejkalim të objektivit për +12.92%.

Spektori i Thesarit.- Në këtë sektor punët dhe detyrat e punës, janë kryer si vijon:

- numëri i shërbimeve lidhur me arkëtimin e parave të imta për shërbime në Administratë 24087, Gjeodezi 5281, Urbanizëm 478, shërbimet, Financa 6800, Shendetësi 947, Arsim 551, Bujqesi 487, Shërbime Publike 266, Z. Kryetarit 552, gjithsej: **39449** shërbime për arkëtim të parave të imta. Përveq arkëtimit, është bërë përgatitja dhe depozitimi ditor i parave në llogarinë bankare të Komunës.
- regjistrimi i të hyrave vetanake të arkëtuara është bërë për çdo ditë në database dhe në sistemin e Free-balancit,
- transferi i të hyrave vetanake nga llogaria bankare komunale në llogari të thesarit MF për çdo fund muaji,
- barazimi i raporteve të arkës me raportet e bankës dhe kontrollimi i tyre për çdo ditë,
- hartimi i raporteve mujore për të hyrat vetanake për nevojat të ekzekutivit dhe MF-së,
- punët lidhur me pasurinë komunale të dhën në shfrytëzim,
- zotimi i parave publike për qëllime të pagimit të shpenzimeve operative dhe kapitale, sipas modulit të blerjes, numëri i lëndve 850 dhe sipas modulit të aprovimit, në numër prej: 696,
- kryerja e pagesave nga buxheti i komunës (dhjetë drejtorate dhe tri zyre komunale për të gjitha lëndët që kanë qenë të kompletuara, në numër prej: 3253 Vlen të cekët se 100% e lëndve të pranuar në zyrën e pagesave janë proqesuar për pagesë. Nëse bëjmi një krahasim të këti shërbimi me një vit më parë, vërehet se kemi patur rritje të lëndve për +1.13% ,
- kryerja e barazimeve mujore me Departamentin e Thesarit ,
- përgatitja e analizave mujore lidhur me zhvillimin e buxhetit komunal sipas sektoreve kryesor dhe programeve,
- bazuar në Rregulloren MF nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore është bërë regjistrimi i pasurive jo financiare kapitale të evidentuara në vlerë prej: **3.058.945,28€**, ndersa totali i pasurive jofinanciare kapitale është në vlerë prej: **494.991.578,71€**. Në këtë vlerë janë përfshirë tokat, ndertesat, pajisjet, infrastruktura, si dhe automjetet, pasuri komunale. Pra në SIMFK janë të përfshira të gjitha këto kategori. Duke siguruar dokumentacionin siq edhe kerkohet me Rregullore për të regjistruar një pasuri .

Sektori i Financave.- Në vitin fiskal/015, përmes Sektorit të Financave janë kryer këto punë dhe detyra pune:

- çertifikimi-aprovimi i dokumentacionit financiar për buxhetin komunal sipas programeve – drejtorateve dhe zyreve komunale me modulën e blerjes, në numër prej 1952 lëndë,
- çertifikimi-aprovimi i lëndve për pagesë sipas modulit të aprovimit, në numër prej 1301 lëndë,
- përgatitja e regjistrimit të faturave të paguara për dosjet e dokumentacionit financiar,
- është mbajtur evidencë analitike për të gjitha lëndët e çertifikuara-aprovuara sipas shpenzimeve veq e veq,
- raporti i punës-financiar për vitin /2014
- pasqyrëzat financiare për vitin /2014,
- raporti i kategorisë ekonomike të shpenzimeve kapitale për Ministrin e Financave dhe Kryetarin e Komunës,
- raportet mujore financiare,
- raportet periodike financiare/015,
- plani i punës për vitin 2015
- regjistrimi i të gjitha lëndëve të aprovuara në librin e dorëzimit për arhivë dhe dorëzimi i tyre për arhivim sipas dispozitave ligjore.

Me buxhetin komunal /015, DBF ka planifikuar të arkëtoi mjete në shumë prej: **380.000,00€**; ndërsa me gjendjen e të dhënave 31.12/015, janë arkëtuar mjete në shumë prej: **424.550,01€**, apo shprehur në përqindje **+11,72%** më shumë.

Nga Drejtorati për Buxhet dhe Financa, gjatë vitit raportuese, janë kryer edhe shumë punë dhe detyra tjera të punës që nuk janë evidentuar më lartë e të cilat kanë ndihmuar punën e Bordit të Drejtorëve, Komitetit për Politikë dhe Financa , Kuvendin e Komunës, si dhe Ministrinë për Financa.

Masat e propozuara- Për të qenë sa më efikas në kryrjen e punëve dhe detyrave të punës, që janë të parapara me Statutin Komunal, Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit, rregulloret dhe vendimet në fuqi dhe programin e punës, D.B.F propozon këto masa:

- vendosjen e adresave dhe numërave në objektet e pa luajtshme në tërëtorin e Komunës së Drenasit,
- informimin e obliguesve të tatimit në pronë që t'i paraqesin ndryshimet eventuale në pronën e tyre siq janë: Ndërtimi i shtëpive dhe objekteve tjera të reja, ndërtimi i destinimit të objekteve për mënyrën e shfrytëzimit, si dhe informimi për objektet e rrënuara,
- rritja e stafit në Zyrën e Tatimit në Pronë,
- vazhdimi i aplikimit të masave për moskryerjen e disa shërbimeve komunale ndaj obliguesve tatimor,
- krijimi i mundësive për stimulimin e punëtorëve në punë,

DREJTORIA PËR KADASTËR, GJEODEZI DHE PRONË

Kjo Drejtori kryen një veprimtari specifike, profesionale të punëve dhe detyrave të punës me interes të përgjithshëm të qytetarëve, personave civilë –juridikë. Mban evidencën e të gjitha paluajtshmërive dhe Tokave të Komunës së Drenasit, të ndarë në 35 zona kadastrale, lidhjen e Hipotekave dhe Regjistrimit të Drejtave mbi Pronën e Paluajtshme, kadastrin etazh, etj.

Sektori për Kadastrë

Kontrata mbi shitblerjen e pronave të paluajtshme	113
Kontrata mbi dhurimin e pronës se paluajtshme	60
Kontrata mbi qirambajtjen – nënqirambajtjen për 99 vite	15
Regjistrim të hipotekave mbi paluajtshmëri	86
Fshirje të hipotekave mbi paluajtshmëri	36
Aktvendime mbi trashëgiminë	97
Regjistrimin e së drejtës së qira mbajtje për 99 vite	15
Regjistrime të drejtës së pronës në shfrytëzim të përhershëm	
Kontrata mbi ndarjen e bashkësisë familjare	8
Regjistrime të ndarjes së parcelave	
Regjistrime të drejtave të pronës së paluajtshme tjera	
Ndarje parcelash	46
Bashkim parcelash	18
Regjistrim ndërtese	31
Korrigjime	34
Raste tjera	34
Barra tatimore	2

Gjithsej : lëndë -595

Certifikata pronësore dhe certifikata për ndihmë sociale gjithsej: 6,901 janë lëshuar gjatë vitit raportues.

Bashkëpunimi i Drejtorisë me organe dhe subjekte tjera të Komunës

Në Bordin e Ankesave për Tatimin në Pronë janë vendosur ankesa të palëve të ndryshme, njëri anëtar është nga kjo Drejtori. Me Drejtorinë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit për të gjitha projektet, punët gjeodezike janë kryer nga punëtorët e kësaj Drejtorie, sidomos me rastin e ndërtimit të rrugëve lokale në përkufizimin e tyre.

Sektori për Gjeodezi

Realizimi i detyrave të punës në nivel të sektorit për gjeodezi dhe në tërësi në kuadër të Drejtoratit është i bazuar në planprogram, në detyrat që kanë dalë gjatë procesit të punës dhe punët e paplanifikuara. Nga lëmi i matjeve në terren, sipas llojeve janë realizuar këto punë dhe detyra:

-Kërkesat për matje97 raste,

pavarësisht sipërfaqen dhe numrin e parcelave;

-Azhurnim dhe bashkim i parcela24 raste

-Regjistrim i banesave, lokaleve në kad. etazh 28 raste

-Ndërrim i kulturës, kontrollimi dhe lëshuarja e koordinatave.....36 raste

-Përtëritje kufiri, rregullim i mezhdës31 raste

Gjithsej : 216 kërkesa të terrenit

Nga puna në terren shihet se pjesa dërmuese e gjeodezisë është në matje dhe mirëmbajtje të matjeve që kjo në fakt kërkon edhe angazhimin më të madh në terren dhe në zyrë në pjesën e azhurnimit. Këto lëndë 97 raste dhe kërkesat për azhurnim nga kompanitë e licencuara dhe bashkimin e parcelave, përveç tjerash janë të pajisura edhe me manuala (doracakë). Nga këto dy lloje të punëve gjeodezike, vlen të ceket se kemi pasur raste nga dy parcela për matje, azhurnim apo bashkim i parcelave deri në 40 sosh të reja me sipërfaqe të ndryshme për një kërkesë. Në lëmin e marrëdhënieve pronësore në terren janë shqyrtuar me matje 36 raste dhe ju kanë dorëzuar të dhënat e nevojshme sektorit të pronës. Gjatë vitit i kemi pasur edhe disa raste ku është dashur të kryhen matje dhe punë tjera gjeodezike, qoftë për rrugë, për përgatitjen e të dhënave për pronat në rastet kur kompanitë e ndryshme janë interesuar të investojnë në territorin e komunës sonë. Gjatë realizimit të projektit të Rindërtimit të Kadastrit në 5 fshatra të komunës sonë, duke u bazuar në pakënaqësitë e anëtarëve të zonave për rindërtim dhe qytetarëve të këtyre zonave, ekspertët e gjeodezisë të kësaj Drejtorie kanë dalë në terren në zonat kadastrale Gllanasellë, Negroc dhe Abri e Epërme dhe është një raport. Në vitin 2015, në bazë të vlerësimeve tona dhe planifikimit të punëve të terrenit është menduar se do të ketë më pak punë bazuar në faktin se 21 zona kadastrale të përfshira në masën komasative janë në procedurë të përfundimit të çështjes së komasacionit si dhe 5 fshatrat e lartcekura në rindërtim të kadastrit, kryesisht nuk kemi pasur kërkesa në këto zona kadastrale. Nga kjo është dashur të kemi më pak kërkesa për terren, por ka ndodhur e kundërta, pasi që numri i kërkesave është rritur krahasuar me vitin paraprak. Puna me palë është kryer kryesisht mirë, pala nuk pret kur i ka të dhënat të azhurnuara, dokumentacionin e merr për pak minuta. Janë lëshuar 795 kopje të planit, si dhe skica për nevoja të ndryshme. Nga pjesa financiare është një arritje e konsiderueshme e punëve që kryhen me pagesë. Edhe në këtë vit ka vazhduar trendi që në muajt shkurt, maj, qershor dhe dhjetor janë të hyrat më të vogla.

Sektori i pronës

Gjatë periudhës kohore nga janari e deri në dhjetor të vitit 2015 në Sektorin e Pronës janë kryer përafërsisht të gjitha punët sipas plan-programit të punës për vitin 2015. Janë shqyrtuar të gjitha kërkesat e paraqitura nga administratorët e fshatrave, madje kërkesat nga personat juridikë e fizikë si dhe kërkesat në bashkëpunim me organet tjera të Komunës e që janë në lidhshmëri me sektorin e pronës. Shprehur në gjendje numerike në periudhën raportuese të këtij viti janë realizuar 36 kërkesa të paraqitura, do të thotë se kemi qenë në terren për 36

raste, kemi zhvilluar procedurë administrative dhe të gjitha këto raste janë përfunduar me sukses. Është zhvilluar edhe procedura për 16 raste ku është uzurpuar prona publike (kryesisht të rrugëve publike) e që për 12 raste është përfunduar procedura, janë lëshuar 12 aktvendime në shkallë të parë, gjithashtu në shkallë të dytë janë verifikuar dhe janë vërtetuar gjer më tani 4 aktvendime, të cilat kalojnë për ekzekutim në Drejtoratin e Inspeksionit. Janë trajtuar disa raste lidhur me shpronësimin e pronave në territorin e komunës sonë për ndërtim të autostradës, si dhe disa raste për vendosjen e largpërçuesve nga KEK-u, disa lëndë kontestuese lidhur me eksproprijimin e mëhershëm të pronave nga Gurthyesi në Çikatovë të Vjetër. Pastaj është verifikuar gjendja e pronave sipas elaboratit për shpronësim në rregullim të shtratit të lumit Drenica. I kemi trajtuar dhe u janë kthyer 8 përgjigje zyrtare me shkrim atyre palëve që kontestet e paraqitura i kanë në zonat komasative e që ne i kemi orientuar në Komisionin për Komasaçion të komunës së Drenasit i cili është në funksion. Janë shqyrtuar disa oferta për shitblerje të paluajtshmërive nga palët dhe për këto raste nga ky sektor janë lëshuar 45 Certifikata që Komuna nuk është e interesuar për blerje të pronave –paluajtshmërive nga personat fizikë (ofertuesit). Janë lëshuar 40 Certifikata që pronat e shitura/blera nga personat fizikë dhe juridikë në territorin e Komunës së Drenasit nuk kanë qenë të nacionalizuara. Në vazhdimësi kemi bashkëpunuar me Sektorin e Gjeodezisë dhe të Kadastrit, si dhe me Drejtoratin për Inspeksion dhe organet tjera.

Projektet e realizuara gjatë vitit 2015 nga kjo drejtori

Projekti i Elaboratit të ndërrimit të destinimit tokave për nevoja të komunës në rrugën M9. Në zonat kadastrale: Arllat; Llapushnik; Komoran; Zabel i Ulët; Zabel i Epërm; Korroticë e Epërme dhe Sankoc, vlera e projektit: 30,000.00 euro. Projekti është kryer në dy segmente. Hartimi i elaboratit kadastral për ndërrimin e destinimit të tokës për nevoja të komunës: segmenti: I, d=14.85 km; segmenti: II, l=2.5 km gjithsej: 17.35 km. Ndërrimi i destinimit parashihet të bëhet në të dyja anët e rrugës nga 150 m, pas marrjes së pëlqimit nga ministritë përkatëse.

Projekti **RINDËRTIMI I KADASTRIT** - Komuna e Drenasit në vitin 2015 ka qenë përfituese e PROJEKTIT për rindërtimin e kadastrit për 5 zona kadastrale: Negroc, Fushticë e Epërme, Abri e Epërme, Gllanaselle, dhe Likoshan; projekt i financuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës 30% dhe Banka Botërore 70%. Fillimisht ky projekt ka filluar me njoftimin e qytetarëve për projektin Rindërtimi i Kadastrit nëpër këto zona. Me rastin e fillimit të punëve në terren nga operatori (Kompania "Lorenco&CO" nga Shqipëria) për kryerjen e matjeve gjeodezike, qytetarët qysh në fillim kanë shprehur pakënaqësitë e tyre për operatorin i cili nuk e ka kryer punën ashtu siç është e përcaktuar me ligje për rindërtimin e Kadastrit, duke i anashkaluar matjet e tokave me kulturë pyje me arsyetim që nuk mund të matim kufijtë për shkak të vegjetacionit e nganjëherë duke thënë se nuk i kam në kontratë matjet e tyre. Pas kësaj, përfaqësuesit e zonave kadastrale, anëtarë të Komisionit kanë filluar me kërkesat ndaj operatorit që të kryejë punët sipas kontratës, por prapë nuk ka ndodhur asnjë përmirësim. Unë, si anëtar i Komisionit komunal, sipas funksionit, kam dërguar shkresa në adresë të Agjencionit Kadastral të Kosovës, duke i njoftuar që punët e terrenit janë duke u anashkaluar: Të përmirësohet operatori ose të ndërpritet kontrata. Por edhe AKK-ja e ka mbrojtur punëkryesin, duke u mundur të hedhë fajin tek qytetarët që nuk po bashkëpunojnë e tjera arsye. Edhe në takimet që kemi pasur në Agjencionin Kadastral të Kosovës me përfaqësuesit e këtyre zonave i kemi shprehur pakënaqësitë për parregullsitë e realizimit të këtij, mirëpo vërejtjet tona nuk i kanë marrë për bazë anëtarët e komisionit të caktuar nga AKK. Andaj, unë si anëtar i këtij komisioni, përfaqësues i Zyrës Kadastrale si dhe anëtarët nga zonat kadastrale: Negroc, Abria dhe Gllanasella këtë projekt e konsiderojmë të dështuar dhe nuk e kemi pranuar, duke mos e nënshkruar asnjë proces apo vendim lidhur me pranimin e këtij projekti. Përgjegjësinë për mosrealizim të këtij projekti e bartin përfaqësuesit e AKK.

Sqarim: Përbërja e komisioneve

Agjencioni Kadastral i Kosovës 2

Ministria e Planifikimit

1

Komuna

1

Përfaqësuesi i Zonës Kadastrale 1

Vërejtje:

Në mungesë të elaboratit kadastral, të marrë gjatë luftës nga forcat serbe, kjo Drejtori ka probleme për të sqaruar historikun e pronave, si private shtetërore, ashtu dhe komunale. Shpresojmë që Qeveria e Republikës së Kosovës shumë shpejt do ta kthejë Elaboratin kadastral gjatë bisedimeve me Serbinë.

DREJTORIA E INSPETRIATIT

Drejtorja e Inspeksionit, punët dhe detyrat e punës për vitin 2015 i ka kryer duke u bazuar në Dispozitat e Përgjithshme Administrative të Ligjeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Rregulloreve të Komunës së Drenasit si dhe planit të punës. Mënyra e menaxhimit, punës dhe mbikëqyrjes inspektuese ka qenë në nivel të aktiviteteve të rëndësishme varësisht prej punës dhe detyrave të punës se a kanë qenë ato rutinore, operative apo strategjike. Kështu që gjatë kryerjes së detyrave zyrtare, inspektorët gjithnjë kanë qenë mjaft transparent, bashkëbisedues për dialogë të hapura dhe shumë të përafërt e Komunës së Drenasit. Për vitin 2015 është hartuar plani i punës, raportet, plani buxhetor për ndarjen e mjeteve për financim për vitet 2016-2018 (kërkesat e para fillestare dhe finale). Plan i zotimeve dhe shpenzimeve të buxhetit për këtë Drejtori është realizuar sipas planit dinamik si dhe të kërkesave dhe nevojave buxhetore. Gjatë periudhës raportuese janar-dhjetor 2015 vazhdimisht është bërë koordinimi i punëve në teren dhe është bërë përcjellja e punës së inspektorëve në të gjitha lemitë inspektuese. Një bashkëpunim të mirë kemi pasur me PK-ës e cila ka asistuar qdoherë sipas nevojës si dhe me Gjykatën Themelore dega në Drenas.

Menaxhimi, arritjet kryesore, performanca kyçe në periudhën janar-dhjetor 2015 për realizimin e prioriteteve:

- Inspektimet lidhur me tregtimin me pakicë, paisjen e subjekteve afariste me qertifikata të biznesit si dhe inspektimet mbi blerjen, shitjen, çmimet, deklaracionin e mallit, mbrojtjen e konsumatorit, zbatimin e orarit të punës etj
- Mbarëvajtja e tregjeve javore në Drenas dhe Bushat
- Mbikëqyrja e kualitetit të ushqimit, të produkteve të ambalazhuara dhe të paambalazhuara.
- Inspektimi rreth higjenes dhe kushteve higjelo-sanitare etj.
- Inspektimi rreth ndotësve të ambientit
- Mbikëqyrja e tregjeve, rrugëve, trotuareve, e sidomos inspektimi rreth ujërave të zeza në zonat rurale.
- Inspektimet e subjekteve afariste për kryerjen e obligimeve (taksave komunale),
- Mbikëqyrja e kompanive të transportit në komunikacionin rrugorë, orari i udhëtimit, lejet e operimit, rendet e udhëtimit, stacionet, parkingjet etj.
- Mbikëqyrja e ndertimit në sektorin publik dhe privat rreth punimeve dhe pajisjes me leje të ndertimit, si dhe ndalimi i punimeve të objekteve pa leje dhe marrja e masave të nevojshme.
- Rrëtimi i ish Objektivit Zhitopromet si dhe ekzekutimi i aktvendimeve të DGJKP 3 raste.
- Janë kryer edhe punë tjera sipas kërkesave dhe nevojave në teren.

Nga lëmia e Inspektorëve të Tregut

Në lëminë e tregut për vitin 2015 kanë qenë të angazhuar 2 inspektorë ku është bërë inspektimi i subjekteve afariste sipas Ligjit për Tregti të Brendshme si dhe Ligjeve tjera që kanë të bëjnë me tregtinë me pakicë. Një bashkëpunim i mirë ka qenë edhe me ARK-në dhe MTI-në e sidomos në inspektimin e lojërave të fatit si dhe kontrolle gjatë natës në zbatim të orarit të punës së lokaleve hoteliere. Andaj gjatë vitit janë bërë:

- Inspektimet e subjekteve afariste rreth regjistrimit të bizneseve.
- Inspektimet e aktiviteteve tregtare në luftimin e ekonomisë joformale, me qëllim të shmangies së krijimit të monopolit.
- Kontrolle rreth zbatimit të orarit të punës, deklaracionit të mallit dhe kontrollit të çmimit të artikujve.
- Inspektimi i sigurisë së produkteve ushqimore me qëllim të mbrojtjes së konsumatorëve.
- Inspektimet e herëpashershme sipas kërkesave dhe në bashkëpunim me MTI-në në bazë të Ligjit të tregtisë së brendshme.

Janë hartuar 398 procesverbale, 18 aktvendime, 15 pëlqime për ushtrimin e veprimtarisë si dhe janë mbyllur përkohësisht 07 lokale afariste.

Nga lëmia e Inspektorit Sanitar

Nga lëmia e Inspektorit Sanitar është bërë inspektimi i higjienës së ujit, Institucioneve shkollore, artikujve ushqimor, hoteleve, kuzhinave ushqimore si dhe higjiena e objekteve tjera afariste dhe atë:

- Inspektimet rreth higjienës, kontrolles së përgjithshme të artikujve ushqimorë dhe produkteve të përdorimit të përgjithshëm (Marketet, subjektet afariste hoteliere, sallonet e ondulimit etj)
- Kontrolla e higjienës në të gjitha objektet shkollore, parashkollore, Çerdheve të fëmijëve si dhe Shtëpisë së Shëndetit në Drenas.
- Inspektimet rreth zbatimit të Ligjit për kontrollë të duhanit.
- Inspektimi i ujit të pijes sipas kërkesave të qytetarëve.
- Kontrolla rreth librezave sanitare.
- Është bërë asgjësim i mallit me afat të skaduar në vlerë prej 858,95 euro
- Janë hartuar 183 procesverbale, 15 Aktvendime si dhe 2 pëlqime sanitare.

Nga lëmia e Inspektorit të Ambientit

Nga lëmia e Inspektorit të Ambientit ka pasur një bashkëpunim të mirë me DSHPE si dhe GIZ-in Gjerman rreth menaxhimit të mbeturinave. Megjithatë mungesa e infrastrukturës, si mos rregullimi i tregjeve javore, mungesa e kanalizimeve, thertoreve etj. kanë ndikuar mjaftë shumë në ndotjen e mjedisit. Gjatë këtij viti është bërë:

- Inspektimi i hedhjes së mbeturinave afër rrugëve, vendeve publike.
- Inspektimi i mbajtjes së pastërtisë së qytetit.
- Inspektimi i largimit të mbeturinave inerte në vendet ku ka pasur ndërtime.
- Inspektimet e operatorëve të cilët veprojnë në Komunën e Drenasit e që janë ndotës të ambientit (Neë Co Feronikel L.L.C, Gurëthyesve etj).
- Inspektimet sipas kërkesave të qytetarëve rreth kanalizimeve, ujërave të zeza, plehrave, etj-sidomos në zonat rurale.

Gjithsejtë janë hartuar 132 procesverbale, janë shqyrtuar 41 kërkesa, si dhe është shqiptuar 01 dënim mandator.

Nga lëmia e Inspektorit Financiar

Inspektori financiar ka punuar konform Rregullores mbi taksat, ngarkesat dhe gjobat komunale dhe për ka bërë këto inspektime:

- Inspektimi i rregullt i bizneseve të cilat operojnë në territorin e Komunës së Drenasit, lidhur me kryerjen e obligimeve (pagesës së taksës Komunale).

- Komunikimi i drejtpërdrejt me biznese lidhur me obligimet ndaj Komunës dhe të cilat arkëtohen si të hyra vetanake.
- Sqarimi-dhënia e këshillave bizneseve që janë aktive ende të pa regjistruara, mbi procedurat dhe obligimeve ndaj Komunës.

Për këtë janë hartuar 118 procesverbale, 47 vërejtje me shkrim, si dhe janë arkëtuar 97.200,00 euro.

Nga lëmia e Inspektorit të Komunikacionit

Inspektori i Komunikacionit është angazhuar konform Ligjit për transportin rrugor dhe Rregullores për transportin rrugor në territorin e Komunës së Drenasit ku problem ka qenë numri i madh i kombi-taxive që me gjithë punën që është bërë nga Inspeksioni dhe PK-ës ende operojnë në mënyrë ilegale. Nga ana tjetër edhe Operatorët Ekonomik-autobusët nuk kanë kapacitete për të mbuluar në tërësi rrjetin e linjave urbano-periferike të caktuar nga Komuna. Nga kjo lëmi është punuar me sa vijon:

- Inspektimi në komunikacionin rrugor të udhëtarëve të operatorëve ekonomik (autobusët, kombibusët, autotaxit).
- Inspektimi i pajisjes së transportuesëve me leje operimi, orar të udhëtimit.
- Inspektimi në stacionin e autobusëve, rrugë etj, sipas kërkesave dhe në bashkëpunim me Policinë e Kosovës-Njësi në Drenas.
- Për këtë janë hartuar 69 procesverbale, 18 konfiskime të librezave, 09 konfiskime të targave dhe përjashtim të automjeteve nga komunikacioni si dhe 18 kërkesa për kundërvajtje janë përcjellë në Gjykatë.

Nga lëmia e Inspektorit të Ndërtimit

Nga lëmia e Ndërtimit janë bërë inspektime rreth ndërtimit ku përpos procesverbaleve janë hartuar edhe aktvendime për pezullim të punimeve, aktvendime për rrenim, konkluzione, kufizime me shenja zyrtare. Gjatë kësaj periudhe janë bërë:

- Inspektimi rreth lejeve të ndërtimit
- Inspektimi i kushteve urbanistike (leja urbanistike).
- Inspektimi i dokumentacionit teknik (projektet ndërtimore, lejet ndërtimore).
- Lëshimi dhe modifikimi i sanksioneve dhe përgatitja e vendimeve për ndërprerjen e ndërtimeve ilegale.
- Inspektimi i ndërtimit në faza
- Rrëni objektive pa leje
- Lëshuarja e portokoleve për praninë teknike të objekteve.
- Obligimi i shfrytëzuesëve të terasave për lidhje të kontrate për shfrytëzim të hapësirave publike.
- Gjatë kësaj periudhe janë hartuar 156 procesverbale, 50 aktvendime për pezullim të punimeve, 03 aktvendime për rrenim të objekteve, 09 konkluzione si dhe 10 portokole për inspektim në faza.

Pasqyrëza e punës në teren për periudhën Janar- Dhjetor 2015:

Nr.	Lemla Inspektuse	Proces-verbale	Akt-vendime	Pelqi-me	Konkluzione	Fletëparaqitje	Asgjesim malli	Mbyllje lokaleve	Konfiskime	Protokol për inspektim në faza	Rrënimet
1	I. Tregut	398	18	15	-	-	-	07	-	-	-
2	I. Sanitar	183	15	02	-	-	858,95	-	-	-	-
3	I. Ambientit	132	-	07	-	02	-	-	-	-	-
4	I. Financiar	165	-	-	-	-	-	-	-	-	-
5	I. Komunikacionit	69	-	-	-	18	-	-	18 lib.+09tar	-	-
6	I. Ndertimit	156	50	-	09	09	-	-	-	10	03
Totali:		1103	83	24	09	29	858,95	07	27	10	03

DREJTORIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE

Aktivitetet kryesore në periudhën Janar – Dhjetor 2015 për realizimin e prioritetëve.	Performanca kyçe gjatë 12 muajve 2015
Synimi i rritjes për 5% nga planifikimi i fëmijëve që vaksinohen (nga 95% 2011ne 96.24% ne 2015).	- Vaksinimi i fëmijëve në 2015: - Doza të planifikuara për vaksinim 16077 - Të vaksinuar Janar-Dhjetor 2015: 15473 - Vaksinimi bëhet sipas orarit obligativ të përcaktuar nga IKSHP.
Zvoglimi i vdekshmërisë dhe sëmundshmërisë të posalindurve dhe nënave (maternale, para, gjatë dhe pas lindjes) në Maternitet	- Raporti 12 mujor - 2015 për Maternitet: 180/ lindje - Të posalindur Femra: 98 - Të posalindur Mashkuj: 82 - Të posalindur të vdekur: 0 - Vdekje të nënave gjatë lindjes: 0
Zvoglimi i numrit të personave me kujdes të veçantë - tretman rehabilitues-shërues (Koordinim Institucional DSHMS, QKMF dhe OJQ Handikos - sit).	- Në kontunuitet bëhet identifikimi i personave përmes , Handikosit, Qendrës për punë Sociale si dhe Qendrës për shëndet Mendorë bazuar në bashkësi. - Koordinimi i mirë veprimeve DSHMS me këto Institucione, në këtë 12 mujor 2015 Handikosi është ndihmuar me: 10.000 €, pagesë të qirasë 2 raste si dhe 43 raste trajtime mjekësore 5000 € - 1250 gjithsej persona me aftësi të kufizuara - 57 fëmijë rehabilitohen qendër / Handikos Drenas - 1193 raste rehabilitohen, furnizohen material të nevojshëm ortopedik dhe shëndetësorë në shtëpi.

*Përmirësimi i shërbimeve emergjente, Lab, Rtg, Maternitet me pajsjet dhe aparatura mjekësore diagnostifikim / shërim. *Menaxhimi i situatës Epidemiologjike dhe parandalimi i sëmundjeve ngjitëse *Zvoglimi i incidencës së sëmundjeve kardiovaskulare, HIV/AIDS dhe TBC	- Plotësim dhe përmirësimi i resurseve humane të shërbimit me një Doktor (me afat të caktuar) si dhe aktivizimi i projektit në bashkëfinancim Komuna me Caritas Kosova për të sëmure me nevoja të veçanta (projekt bashkëfinancimi 50+50%). Gjithashtu projekti Marrëveshje Bashkëpunimi "Përkujdesje për shëndetin oral-stomatologjik për persona me gjendje të rëndë ekonomike-sociale" me Team Albania organizat nga Norvegjia - Situatë e qetë epidemiologjike gjatë vitit 2015. Përrjashtimisht 29 raste të dyshuara në tularemi - Këshilla dhe ligjërata lidhur me edukimin shëndetësorë për të zvogluar konsumimin e kripës, yndyrës, sheqerit dhe duhanit si dhe ligjerat edukuese lidhur me shendetin e adoleshentëve: duhani, droga, mjetet kontrceptiv etj. Puna me grupe të rrezikuara brenda QKMF-së dhe në teren.
*Përmirësimi i procedurave për qasje në mirëqenjen sociale, qartësimi i kriterëve, përmirësimi i zbulimit të mashtrimit. Rastet e SNS.	- Shtimi i mekanizmit të kontrollit të brendëshëm, bashkëpunimi me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenjes Sociale, Agjencionin Tatimorë të Kosovës si dhe personat shfrytëzues të Skemës Ndhmës Sociale : Gjithsej raste në Skemën Sociale për vitin 2015 janë 1342 raste / Janar-Dhjetor 2015.

DREJTORIA PËR KULTURË, RINI E SPORT

Aktivitetet kryesore 2015 për realizimin e prioriteteve	Arritjet/progresi/përformanca kyçe gjatë 12 muajve / 2015
Aktivitetet kulturore	-U bë hartimi i plan – programit të punës për vitin 2015 -U mbajtë manifestimi për 17 shkurtin ditën e Pavarësisë së Republikës së Kosovës, ku u mbajtë një Akademi Festive, u dha një program kulturo-aristik me këngë e valle nga SHKA „Shotë Galica” . -Me 28 shkurt 2015 në Drenas u mbajtë Akademi Përkujtimore dhe një program kulturor me rastin e 17 vjetorit të betejës se Likoshanit dhe Qirezit. -U mbajtë manifestimi letrar sofa poetike „Ymer Elshani” 2015. -U organizua një koncert i madhë për bashkëatdhetar në sheshin „Fehmi Lladrovci” me 22 dhe 23 korrik -Me 25 tetor ART Club „Rifat Kukaj” mbajti orë letrare . -Me 29 nëntor u mbajtë shfaqja „Stop dhunës në familje” -U mbajt festivali i –XVIII- „Ditët e Humorit Drenasi 2015” me datën 12 dhe 13 nëntor në këtë festival morën pjesë 11 grupe dhe individ nga Kosova dhe Shqipëria. -Me 09 nëntor u mbajtë një shfaqje nga teatri i kukullave „Dodona” nga Prishtina -Me 13 nëntor u bë promovimi i librit „Fortesa e fundprillit 1999” e shkrimtarit Sheremet prokshi” -Me 25 nëntor u bë zgjedhja e misit dhe misterit të Drenasi. Mis u zgjodh Edona Bazaj, mister Adhuri Koca. - Arkivi komunal punën e ka kryer në bazë të planit –programit të vet ku gjatë kësaj kohe janë përpunuar 40 kuti me lëndë arkivore dhe gjysëm përpunuar 30 kuti, janë skanuar 40 dokumente. Janë shqyrtuar 28 kërkesa. -Gjatë këtij viti ka regjistruar 215 anëtar të rinjë, 1750 libra ka dhënë në lexim lexues të rregullt 355 , fondit prej 7520 libra ju kanë shtuar edhe 500 libra këtë vit 8020. Bibloteka në Arllat ka regjistruar 95 anëtar të rinjë, ka dhënë në lexim 3960 libra. Lexues të rregullt ka 387 (4887 ekzemplar). Bibloteka në Tërsetnik ka regjistruar 125 anëtar të rinjë, ka dhënë në lexim 4189 libra, gjithësejt lexues 230. (4000

	ekzepmlar) -SHKA, „Shotë Galica” gjatë këtij viti ka marrë pjesë në këto festivale: „Flakadani i Karadakut” Viti; e „Anadrinia Jehon” Dejë; „Hasi Jehon” Gjonaj; Fushë Arrëz; „Kamza 2015” Tiranë; „Oda e Llapushës” Malidhevë; „Eshkë e Ndezur mbi Shkelzen” Deqan; „Gjirokastra 2015”; „Burimet e Sharrit” Tetovë; „Syzi 2015” Obiliq; „Festivali i 53 i këngëve për fëmijë” Shkodër; „Shkupi 2015”: ku nga të gjitha këto festivale u kthyer me shperblime. -Sektori i Kulturës gjatë tërë vitit me rastin e përvjetorëve të dëshmorëve, festave të shkollave fillore, turnireve të ndryshme sportive, akademive, shfaqjeve, koncerteve, bëri dekorimin dhe mbajti zërimin.
Aktivitetet sportive	-U mbajtë turnir në futboll të vogël me institucionet komunale me rastin e ditës së Pavarësisë së Kosovës. -Me rastin e 28 shkurtit Betejës së Likoshanit-Qirezit u mbajtë turnir në futboll të vogël. -U mbajtë krosi komunal pranëveror dhe vjeshtor -U mbatën garat e shkollave fillore në futboll, hendboll(M&F) dhe volejboll(M&F) ku morën pjesë 27 shkolla fillore. Në plasman të përgjithshëm vendin e parë e zuri SH.F.M.U „Rasim Kiqina” Drenas. -Turniri në futboll të vogël „Rasim Kiqina” u mbajtë nga data 30 maj deri me 14 qershor 2015 ku morën pjesë 108 ekipe nga të gjithë Kosova. Këtë vit ky turnir u mbajtë nën patronatin e Kryetarit të Komunës Z. Nexhat Demaku. Vendin e parë e zuri FC „Feniksi” Drenas. -U ndihmuan financiarisht të gjitha klubet varsishtë nga kategoria dhe suksesi. -Në garat në nivel të Kosovës të cilat u organizuan në bashkëpunim me shoqatën e Pedagogëve të Kulturës Fizike u arritën këto rezultate: vendin e dytë në volejboll për femra i takoj Gjimnazit „Skenderbeu” Drenas. Ekipet e komunës sonë në këto gara shënuan suksese shumë të mira. Vendi i dytë në futboll të vogël i takoj Gjimnazit „Skenderbeu” Drenas -Këtë vit KF „Feronikeli” u bë kampion i vjeshtor, i Kosovës dhe fitues i kupës. -Gjatë këtij viti komuna jonë u bë me një objekt të ri –stadioni sintetik në të cilën do të mund të zhvillojnë ushtrime dhe ndeshje të gjitha klubet sportive të komunës sonë. -Këtë vit po ashtu u bë renovimi i stadionit Rexhep Rexhepi. -Si çdo vit edhe këtë vit u bë zgjedhja e më të mirëve në lëmin e sportit. Sportisti i vitit u zgjodh Behar Maliqi KF „Feronikeli”
Aktivitetet rinore	- U mbajtë takim pune me grupet rinore dhe OJQ e komunës për informim rreth aktiviteteve rinore të këtij Sektori. -U mbajtë një takim regjional me OSBE-në në Mitrovicë ku merrni pjesë Mitrovica, Podujeva, Vushtrrija dhe Drenasi. Në këtë takim u bisedua për të drejtat e të rinjëve. -U organizua një mbrëmje muzikore për nder të 14 qershorit ditës së çlirimit të Drenasit. -Në KVRL u mbajtën zgjedhjet me pjesëmarrjen e 12 OJQ-ve të komunës sonë. -Me 22.05.2015 me organizatat rinore kemi marrë pjesë në pastrimin e qytetit. -U përgadit dhe doli revista „Realiteti” me rastin e 14 qershorit ditës së çlirimit të Drenasit -Me rastin e ditës së rinisë në komunën e Drenasit u organizua debat me përfaqësues nga Komuna, zyrtar Rinor, KVRL, dhe me të rinjtë e forumeve rinore, turnir në futboll të vogël, turnir në shah, turnir në volejboll, gara me handikosin dhe mbrëmje rinore. -U mbajtë trajnim 7 ditor për Ngritjen e Kapaciteteve të Zyrtarëve Rinor Komunal,



KRYETARI I KOMUNËS

NEXHAT DEMAKU